

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

29.03.2023
Ora 12.34

RENDI I DITËS

**Shqyrtimi i kërkesës nr. 11, datë 25.03.2023, e Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
me objekt “Vendosje sanksionesh administrative”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **KRIIK:** Znj. A. Male.
- **Të tjerë:** Z. E. Pishkashi, Bashkia Prrenjas.

Z. L. Braho: Mirëdita! Çelim seancën e shqyrtimit administrativ të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.11, të datës 25 mars 2023. Me vendimin e datës 28 mars, kjo kërkesë, duke qenë se plotësonte elementet e formës dhe përmbajtjes në zbatim të nenit 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, u kalua për shqyrtim administrativ sot në këtë seancë. Në këto kushte do të vijojmë me çeljen e shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka kërkuar që të vendoset sanksion administrativ ndaj 10 subjekteve në lidhje me shkeljet që ata kanë kryer në zbatim të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Më konkretisht kërkohet vendosje e sanksionit me gjobë për:

zotin Armando Subashi kryetar në Bashkinë e Fierit;

zotin Nuri Belba kryetar në Bashkinë e Përrenjasit;

zotin Kastriot Gurra, kryetar në Bashkinë e Librazhdit;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive publikë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;

Bashkinë e Poliçanit;

Bashkinë e Skraparit;

Bashkinë e Roskovecit;

Bashkinë e Lezhës;

Bashkinë e Bulqizës;

dhe në Bashkinë e Elbasanit.

A ka ndonjë përfaqësues nga këto palë për të cilat kërkohet sanksion administrativ?

Po, prezantohuni, ju lutem!

Z. B. Pishkashi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Përrenjas: Unë jam Bajram Pishkashi, personi përgjegjës i autorizuar nga bashkia për të raportuar në KQZ, lidhur me veprimtaritë politike dhe aktivitetet.

Z. L. Braho: Çfarë pozicioni keni në Bashkinë e Librazhdit?


Z. B. Pishkashi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Përrenjas: Unë jam sekretar i Përgjithshëm i bashkisë.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj e keni autorizimin?

Z. B. Pishkashi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Përrenjas: Unë jam loguar dhe përdor dhe sistemin.

Z. L. Braho: Pra, konfirmohet që është zotëria personi që raporton?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. B. Pishkashi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Përrenjas: Po.

Z. L. Braho: Një kartë identiteti, ju lutem! Mirë palë të tjera nuk ka. Po ashtu i pranishëm është edhe sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, të cilin e ftojme si fillim të relatojë në lidhje me këtë kërkesë të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Po, zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më datën 24 mars ka marrë në shqyrtim denoncimet, të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Janë denoncuar 20 veprimtari publike, nga 10 institucione për shkelja administrative në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Denoncimet dhe indiciet janë marrë nëpërmjet provave *link*, të administruara në Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Konkretisht për Bashkinë e Fierit, ka administruar denoncimin regjistruar me numrin 40, 41 dhe 167 ID për të cilën pretendohet sa vijon: Bashkia e Fierit ka raportuar si aktivitet të institucionit në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve aktivitetin e planifikuar për ta zhvilluar më datën 28 janar 2023, sipas përshkrimit të të cilit komuniteti i njësisë administrative Dermenas ka paraqitur pranë njësisë një kërkesë me shkrim ku ka kërkuar një takim me kryetarin e bashkisë. Në takimin e zhvilluar ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste të Qarkut të Fierit, i zgjedhur deputet në Qarkun e Elbasanit, zoti Taulant Balla. Në përmbajtje të fjalimit të tij u konstatuan lehtësisht dhe haptazi thirrje që bëjnë këtë aktivitet të natyrës elektorale. Videot e aktivitetit gjenden të postuara në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë së Fierit, zotit Armando Subashi. Ky aktivitet është transmetuar të paktën nga dy medie audiovizive dhe konkretisht nga Vizon Plus Tv

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

dhe TV Kombi. Në aktivitet, përpos të tjerëve, kanë marrë pjesë dhe kanë folur si pjesëmarrës zoti Tulant Balla dhe zoti Petro Koçi, deputetë të Partisë Socialiste. Në përmbajtje të fjalimit të tyre janë konstatuar lehtësisht dhe haptazi thirrje që e bëjnë këtë aktivitet me natyrë elektorale. Aktivitetet publike, të kryera nga kryetari i bashkisë, gjenden të raportuara në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve këto aktivitete nuk përbëjnë veprimtari të ndalur në kuptim të nenit 3 të vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Megjithatë, gjatë zhvillimit të takimeve ka pasur pjesëmarrje të deputetëve Balla dhe zoti Koçi, të cilët kanë qenë edhe folës të takimeve të organizuara nga Bashkia e Fierit. Kryetari i bashkisë gjatë hetimit administrativ nuk arriti të provojë objektivisht se pavarësisht masave të marra nga ana e tij nuk ka mundur të ndalojë përdorimin e thirrjeve me përmbajtje elektorale nga ana e pjesëmarrësve. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka arritur në konkluzionin se zoti Armando Subashi ka shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe i ka propozuar KAS-it për marrjen e masës administrative me gjobë në masën 10 mijë lekë.

Z. Ledio Braho: Faleminderit, zoti Merkaj! A ka pyetje nga kolegët, që t'i bëjmë rast pas rasti secilën nga kërkesat?


(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju jeni?

Znj. A. Male: Unë përfaqësoj organizatën KRIIK Albania. Quhem Antuela Male. Doja të merrja fjalën në parantezë duke qenë se të gjitha këto indidcie, të cilat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. L. Braho: Jeni në cilësinë e vëzhguesit?

Znj. A. Male: Do ta sqaroj pozicionin, nëse do të më jepni 2 minuta kohë.

Z. L. Braho: Po, sqaroni pozicionin.

Znj. A. Male: Ne jemi organizatë që prej vitesh monitorojmë proceset zgjedhore duke evidentuar problematikën e vërejtur në zgjedhjet e vitit 2021 lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore dhe mosfunksionimin e mekanizmit të monitorimit përdorimit të këtyre burimeve. Jemi shumë të fokusuar në këtë proces lidhur me këtë mekanizëm. Doja të theksoja që në mënyrë periodike, që nga data 13 janar dërgojmë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve raporte javore ku përcillen në formën e indiceve të gjitha ato probleme ose shkelje ligjore që ne kemi vërejtur lidhur me institucionet publike. Të gjitha indiciet e përcjella nuk janë në formën e denoncimeve. Në gjykimin tonë i gjithë mekanizmi është ndërtuar në mënyrë të tillë që t'iu japë të gjitha palëve të treta mundësinë që të vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. I vetmi ndryshim ndërmjet faktit që ne i përcjellim si indicie dhe jo si denoncime është fakti që ne nuk duam të jemi palë e mirëfilltë proceduralisht në proceset administrative, të cilat zhvillohen në KQZ. Duke qenë se KAS-i është pjesë integrale e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ne gjykojmë që duke pasur bashkëpunim me administratën dhe Komisionerin, gjithashtu, të gjitha indiciet e përcjella nga ne, pjesë e hetimit administrativ, të bërë nga administrata, e gjithë barra e provës e lidhur me to duhet t'i kalojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për këtë arsye ne nuk e konsiderojmë veten palë në këtë proces. Pavarësisht kësaj, në mënyrë periodike me synim fuqizimin e institucionit në kontrollin e këtij mekanizmi kemi dërguar të gjitha shkeljet e vërejtura prej nesh në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

mënyrë periodike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Dua të theksoj, gjithashtu, që të gjitha pikat që janë sot në projektvendimin e Komisionerit të përcjella tanimë në KAS, janë indicie të përcjella nga KRIIK dhe konsistojnë në aktivitete të paraportuara dhe në shndërrimin e aktiviteteve institucionale në fushatë elektorale. Paraprakisht kemi kërkuar nga KQZ-ja që të gjitha këto aktivitete, të cilat njoftojnë paraprakisht pjesëmarrjen e deputetëve në aktivitetet e bashkive dhe aq më tepër, pjesëmarrjen e drejtuesve politikë të qarqeve në aktivitet institucionalë të bashkive duhet të ndalohen. Për këtë arsye ftojme KAS-in që me një interpretim të zgjeruar ta konsiderojë këtë pjesë shumë të rëndësishme, në gjykimin tonë. Marr shkas edhe nga fakti që aktivitete të tilla faktuar tashmë janë shndërruar në aktivitete elektorale. Shumë bashki përcjellin pretendimin që nuk mund t'i kontrollojmë deputetët apo drejtuesit politikë në fjalimet tyre, pavarësisht se ato zhvillohen në aktivitet institucionale përkatëse. Kjo mund të jetë një arsye që i gjithë ndalimi i pjesëmarrjes së tyre të vijë paraprakisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Duhet të shkohet përtej institucionit të partisë politike, të cilat tanimë janë të regjistruara edhe si subjekte zgjedhore dhe, aq më tepër, edhe të përfaqësuesit të këtyre partisë politike në rastin konkret është zoti Balla dhe zoti Gjijnuri, të cilët janë drejtues politikë të qarqeve Fier dhe Elbasan. Ky është i gjithë pozicioni ynë, jo si palë në proces. Nëse ju keni ndonjë pyetje lidhur me këtë pozicion gjithmonë, jo me përmbajtjen e akteve, për të cilat KQZ-ja tanimë e ka bërë hetimin administrativ, unë jam e hapur të përgjigjem. Dua të theksoj edhe diçka tjetër të fundit që të gjitha indiciet e përcjella janë në formën e denoncimeve sepse janë të shoqëruara me fakte konkrete, jo vetëm linqet e publikimeve, jo vetëm pjesëmarrja nëpërmjet fotografive, por edhe transkriptimi i të gjithë fjalës që ka përmbajtje të fushatës elektorale të përfaqësuesve në secilin aktivitet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. L. Braho: Faleminderit! Në fakt, një nga kërkesat që ne kemi nga Komisioneri këto rezultojnë denoncime. Besoj se Ylli mund të na e sqarojë pak më mirë këtë situatë. Tani, këto kanë nisur në bazë të denoncimeve, indicieve? Proceduralisht për Komisionerin, si ka funksionuar kjo pjesa paraprake?

Znj. I. Osmanaj: Menjëherë, sapo janë administruar raportet e KRIIK-ut në lidhje me mos raportimin e veprimtarive publike sikurse edhe me shpërdorimin e burimeve publike, kemi filluar hetimin administrativ. Ju është përcjellë me kërkesë të Komisionerit si indicie për denoncim. Pra, janë trajtuar si indicie, por hetimi administrativ është njësoj, si për rastin e indicieve, ashtu edhe në rastin kur administrojmë denoncim.

Z. L. Braho: Faleminderit! A ka pyetje?

Z. K. Bele: Zonja Antuela, patjetër puna juaj është e vlerësuar, por ne veprojmë në një kuadër procedural të caktuar, që do të thotë se ne nuk mund t'ju bëjmë palë, gjykoj unë, duke u bërë një bisedë interaktive bashkë për sa kohë ju nuk jeni një pjesë e këtij procesi administrativ. Ju patjetër keni dhënë një kontribut në fazën e hershme të procesit, në atë rrugë që ju gjykoni, por ky hetim administrativ zhvillohet mbi disa rregulla dhe ne jemi të detyruar të komunikojmë me palët që janë pjesë e këtij procesi. Ju mbani qëndrimet tuaja, mendoj unë, jashtë kësaj procedurë ose mund të përfshihen në atë procedurë në formën e caktuar. Pra, puna është voluminoze e vlerësuar. Unë sigurisht kam pyetje, por jam i detyruar t'ia drejtoj palës që është në këtë proces.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. A. Male: Patjetër, ky është i gjithë qëndrimi ynë, pa u bërë palë në proces, por duke shpjeguar për pikat që janë sot në vendim, por edhe për ato që mund të vijnë në vazhdimësi, që ne nuk jemi palë për këtë arsye, por jo se kjo na pengon të sjellim indiciet tona dhe KQZ-ja të vihet në veprim për shqyrtimin e tyre.


Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Jo se ne nuk ju bëjmë dot palë, sepse as Komisioneri nuk ju ka konsideruar si palë, kështu që seanca do të vazhdojë me përfaqësuesin e KQZ-së. Po, zoti Rusmali në lidhje me çështjen.

Z. I. Rusmali: Zoti Merkaj, Komisioneri ka marrë në shqyrtim tri episode nga Bashkia e Fierit, në mos gaboj dhe ka dalë në konkluzionin, siç rezulton nga vendimi i tij nr. 200, se, së pari, veprimtaritë janë raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe së dyti, veprimtaritë nuk janë veprimtari të ndaluara në kuptimin e ligjit. Dakord deri këtu, apo jo? E ka thënë në vendimin e tij nr. 200. Por propozon vendosjen e një gjobe për kryetarin e bashkisë, sepse thotë: Në rastet kur të ftuarit ose folësit në fjalimet e tyre kanë thirrje me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një subjekti zgjedhor ose të një kandidati dhe dalim përtej objektit dhe tematikës së takimit, organizatorit të aktivitetit i lind detyrimi për të marrë të gjitha masat e nevojshme, po them unë, që kjo të mos ndodhë. Me shprehjen “i lind detyrimi” nënkuptojmë një detyrim ligjor për organizatorin e takimit?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rsumali: A mund të na jepni referencën ligjore që të konsultojmë edhe ne detyrimin ligjor?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. Y. Merkaj: Po. Atëherë, arsyetimi i Komisionerit është bazuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor ku thuhet: “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike dhe mbështetësve të subjekteve zgjedhore”. Ideja është që në këtë takim kanë marrë pjesë punonjës të Bashkisë së Fierit. Për sa kohë që kryetari i bashkisë, dhe neni 7 i vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator...

Z. I. Rusmali: Qëndrojmë te neni 91. Ju thoni kanë marrë pjesë punonjës të bashkisë. Kjo e bën veprimtarinë veprimtari të ndaluar, apo jo?

Znj. M. Koja: A mund ta bëni pak më të qartë pyetjen?

Z. I. Rusmali: Komisioneri ka thënë se kryetari i bashkisë ka lejuar personalitete, dinjitarët që të bëjnë fushatë elektorale në një aktivitet të bashkisë dhe nuk ka marrë masa për t'i ndaluar ata. Kjo është ajo që Komisioneri ia gjen si shkelje; e kishte detyrim. Pyetja e parë ishte: Na identifikoni në cilin ligj është ankoruar ky detyrim? Zoti Merkaj tha se është në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe referoi te pjesëmarrja në aktivitet e punonjësve të bashkisë, që është histori më vete, sepse hetimi duhet të kishte nxjerrë edhe kush janë punonjësit e bashkisë. Por nuk ka lidhje me konstatimin e Komisionerit. Megjithatë, unë po e marr si të mirëqenë. Ju kërkoni vendosjen e gjobës për pjesëmarrjen e punonjësve me detyrim të punonjësve të bashkisë në një aktivitet elektorale. Në leximin tim, pjesëmarrja me detyrim e punonjësve të bashkisë, në një aktivitet elektorale e bën veprimtarinë, veprimtari të ndaluar. Ndërkohë që Komisioneri ka thënë se nuk është veprimtari e ndaluar. Këtë kontradiktë a na e zgjidhni dot?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. M. Koja: Për sa është raportuar në ndërfaqe për natyrën e veprimtarisë, nuk përbënte veprimtari të ndaluar në momentin që është bërë vlerësimi i raportimit në ndërfaqe. Më pas, pasi është verifikuar, pas marrjes së indicies, u vërtetua që kjo veprimtari normale, e lejuar e një kryetari bashkie, e një bashkie është vënë në funksion të një partie politike. Pra, është një fakt post, i vërtetuar. Veprimtaria në vetvete, për objektin që ka, për pjesëmarrësit që ka, pa thirrjet politike të një deputeti nuk është veprimtari e ndaluar. Kjo është kuptueshmëria e kësaj.


Z. I. Rusmali: Atëherë, po flasim për dy koncepte të ndryshme. Ka veprimtari që ndalohen në procesin e raportimit dhe ndalohen si veprimtari të ndaluara nga Komisioneri në raportim, kjo është një histori më vete dhe ka veprimtari që konsiderohen veprimtari të ndaluara. Për shembull veprimtari e ndaluar është një veprimtari në të cilën marrin pjesë me detyrim punonjësit e institucioneve publike. Ky është përkufizimi.

Znj. M. Koja: Veprimtari e ndaluar e bashkisë?

Z. I. Rusmali: Nuk ka rëndësi institucioni.

Znj. M. Koja: Po, ka rëndësi patjetër ajo. Mua kur eprori më thotë do të shkojmë në një takim, ai është urdhër dhe unë shkoj. Pra, në këtë kuptueshmëri punonjësit e bashkisë marrin pjesë të dëgjojnë, sepse tematika e takimit ka qenë për të takuar banorët e një njësie administrative dhe për t'iu prezantuar atyre investimet që do të bëhen nga buxheti i Bashkisë së Fierit për vitin 2023. Dhe, pa dyshim, drejtoi i investimeve, specialistët e financës, këta do të marrin pjesë të dëgjojnë. Pra, deri

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

këtu, në vlerësimin tonë kjo është një veprimtari e lejuar, një veprimtari normale e një institucioni.

Z. I. Rusmali: Prapë, më duket se po ngatërrojmë termat. Nuk jam duke u marrë me raportimin. Raportimi është një gjë tjetër. Në nenin 3, të vendimit nr. 9, të Rregullatorit jepen përkufizimet për veprimtaritë e ndaluara dhe një nga këto veprimtari, që ndalohen, përcaktohet nga pika 1/3, shkronja “ç” është “përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore qendrore ose vendore brenda orarit të punës për veprimtari ose aktivitete me qëllime zgjedhore...”, e të tjera. Kuptova, nga ajo që tha Ylli, që jemi në këtë rast, sepse këtu është përdorimi i administratës publike. Tani, kjo dispozitë e ndalon përdorimin e administratës publike gjatë fushatës zgjedhore. Fushata zgjedhore, me përkufizim ligjor, është 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Aktiviteti është zhvilluar brenda këtij harku kohor apo jashtë këtij harku kohor?


Znj. M. Koja: Aktiviteti është raportuar për të paktën 2 të parët: Dermenas Topojë, janë raportuar me datat 25 janar për t’u zhvilluar më 28 janar.

Z. I. Rusmali: Është brenda apo jashtë?

Znj. M. Koja: Jashtë fushatës zgjedhore.

Z. I. Rusmali: Është jashtë dhe do të thotë që nuk është veprimtari e ndaluar, sepse veprimtaria e ndaluar është përdorimi në fushatë zgjedhore. Fushata zgjedhore është 30 ditë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Për elementin e përdorimit në fushatë zgjedhore të punonjësve, po. Por folëm për diçka tjetër më lart. Ne thamë që a është veprimtaria publike apo jo e ndaluar, jo përdorimi i punonjësve. Dua t'ju jap një panoramë si e kuptojmë ne dhe si është kuptueshmëria jonë mbi zbatimin e Kodit Zgjedhor. Pa dyshim që vendosja në dispozicion të një partie politike, por jo vetëm, e burimeve qofshin këto asete. Pra, sende apo edhe administratës është e ndaluar në çdo kohë. Për këtë besoj, biem dakord të gjithë. Asetet e një institucioni publik janë vetëm për të përmbushur funksionin, për të cilin institucioni është ngritur. Pra, në çdo kohë është e ndaluar. Nuk mundet që makina e një kryetari bashkie apo e një ministri të përdoret për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është vënë në dispozicion, qoftë kjo 4 muaj para zgjedhjeve, në fushatë zgjedhore apo jo në periudhë zgjedhore, apo edhe e një personi dhe individi tjetër, pra një biznesi privat. Pra, qëllimi për të cilin janë krijuar, janë vendosur në dispozicion të një bashkie është për të përmbushur funksionin e bashkisë. Unë besoj se të gjithë biem dakord se kjo është e ndaluar në çdo kohë. Por për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve ky kontroll mbi mënyrën e përdorimit bie mbi KQZ-në raport me zgjedhjet e ardhshme. Në periudha të tjera është detyrë e institucioneve të tjera që monitorojnë mënyrën si përdoren fondet publike, është KLSH-ja, janë auditimet e të tjera, nuk është objekti shqyrtim nga KQZ-ja. Merr vlerë për KQZ-në, sikundër Kodi e ka përcaktuar, 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Ne mundohemi ta interpretojmë, ta kuptojmë gjerë të lidhur nenin 91 me nenin 92, sepse ata raportojnë jo për të na thënë ne se çfarë po bëjnë ata, ne nuk na intereson se çfarë bëjnë ministrinë, bashkitë, institucionet qendrore ose vendore. Ne na intereson që këto të mos vihen në shërbim të një partie politike që ka interes në zgjedhje. Ne të gjithë biem dakord që interesi i shprehur i një partie politike fillon në afatet që Kodi përcakton, që janë 70 ditë aplikimi deri në miratimin nga autoriteti nga Komisioneri të regjistrimit. Aty merr personalitet apo shpreh interesin partia për

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

të hyrë në zgjedhje. Pyetja që ne i bëjmë vetes është: Çfarë ndodh nga data 13 janar deri më datën 15 shkurt kur ai regjistrohet? Atëherë, pse raportojnë këta? A merr vlerë raportimi në këtë periudhë apo jo? Këto janë pyetje që ne ia kemi bërë vetes, sepse legjislatori ka vendosur 4 muaj dhe nuk e ka lënë të lidhur këtë me periudhën...

Z. I. Rusmali: Legjislatori ka vendosur 4 muaj detyrimin për raportim.

Znj. M. Koja: Po në funksion të kujt? Thjesht për të marrë ne informacion që çfarë po bëjnë institucionet?

Z. I. Rusmali: Me qëllimin që ju të ndërhyni eventualisht në disiplinimin e veprimtarive publike.

Znj. M. Koja: Në raport me?

Z. I. Rusmali: Në raport me zgjedhjet.

Znj. M. Koja: Pra, të mos vihen në funksion të zgjedhjeve.

Z. I. Rusmali: Pra, në raport me zgjedhjet. Çështja është këtu që ne duhet të identifikojmë se cila është shkelja dhe të themi pse është shkelja. Është e rëndësishme kjo, sepse nuk mund të nisemi nga logjika për të përcaktuar shkeljet. Shkelja duhet të burojë nga ligji, jo nga logjika jonë. Me fjalinë e përgjithshme që është ndaluar, është në të gjithë kohën i ndaluar përdorimi i aseteve për qëllime të tjera, ne nuk shkojmë gjëkund, sepse ne na duhet në kuadër të zgjedhjeve të identifikojmë shkeljet, bazën ligjore, që na mbështet arsyetimin tonë, dhe të

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

identifikojmë edhe masat që parashikon ligji, jo ne, për të ndëshkuar shkeljen. Në këtë kontekst unë kam vështirësi për t'u orientuar, sepse mua më dalin gjithmonë shkaqe që nuk i gjej të mbështetura. Më del fakti që është detyrim ligjor që të orientojë folësit në një aktivitet dhe të jemi të qartë në një aktivitet të bashkisë, jo të subjektit politik. Në një aktivitet apo jo, të bashkisë, se na duket po i vëmë në dispozicion të të tjerëve. Është në aktivitetin e tij kryetari i bashkisë. Pra, në një aktivitet të bashkisë, po vë në dispozicion asetet publike. Kur i ndalohet dhe kur i lejohet ta bëjë këtë punë? Jemi duke diskutuar për një aktivitet publik të kryetarit të bashkisë. Është aktivitet publik propagandistik i tij, apo është aktivitet elektorale i tij? Këtë e ndan ligji. Do ta ndajë ligji këtë gjë. Ligji ndalon kryerjen e një sërë veprimesh në zgjedhje. Jeni ju që do të përcaktoni çfarë nënkuptojmë me zgjedhje? Unë nuk kam asnjë problem që ju të më thoni se me zgjedhje ne nënkuptojmë periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Nuk kam asnjë shqetësim në këtë. Por, nëse Kodi thotë “në zgjedhje”, pa e definuar fjalën çfarë kuptojmë me zgjedhje. Nëse vendimi i Rregullatorit thotë “në zgjedhje” pa e definuar dhe ju vini këtu dhe thoni “në zgjedhje” pa e definuar, ne e kemi të vështirë të orientohejmë, sepse duhet ta kuptojmë ku është gjëja. Kolegu flet për përdorimin e administratës publike, jo të aseteve, por Kodi thotë në fushatë administratën publike, jo në zgjedhje. Ka përkufizimin e vet. Në materialin që na është servitur nga ana e administratës së KQZ-së, konceptet janë sfumuar. Në vendimin e Komisionerit flitet për periudhë zgjedhore, por periudha zgjedhore është koncept tjetër ligjor, nuk ka lidhje me këtë që doni të thoni ju.

Znj. M. Koja: Periudhë zgjedhore është periudha 15 prill-15 maj.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. I. Rusmali: Periudha kur caktohet data e zgjedhjeve, vetëm për kaq, ky term na shërben vetëm për kaq. Nuk na shërben për të ndjekur dhe mbikëqyrur veprimtarinë e institucioneve. Është term që i duhet Presidentit të Republikës të ndajë kur thoni periudhë zgjedhore nënkuptoni fushatën zgjedhore? Kur thoni periudhë zgjedhore nënkuptoni afatin 4 muaj deri në ditën e zgjedhjeve? Këto gjëra duhet të jenë të qarta përpara se të bëhet propozimi për të marrë masën, mendoj unë. Më vjen keq që po e kthej në diskutim këtë gjë, por me pyetjet unë dështova me sa duket.

Znj. M. Koja: Unë mendoj se baza ligjore është e qartë dhe mbi sa pretendohet dhe është parashtruar në vendimin e Komisionerit. Është vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator, në zbatim dhe autorizimin ligjor që Kodi i ka dhënë të nenit 91 dhe 92, i cili në nenin 7 të tij përcakton detyrat e sekretarëve të përgjithshëm dhe drejtuesve të institucioneve publike të pavarura dhe të varësisë, ndër këta janë edhe kryetarët e bashkive të ngarkuar me detyra që do të organizojnë menjëherë punën. Kjo është e lidhur me afatin 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe duhet të marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale. Ne jemi nisur pikërisht tek vënia në dispozicion e veprimtarisë së tyre institucionale. Shtrihet dhe më tej, Rregullatori thotë “mjeteve, fondeve materialeve”. Ne nuk arritëm të provonim dot nëse salla ku ishte zhvilluar veprimtaria, nuk na u dha informacioni nga Bashkia e Fierit, ishte në pronësi të saj? Ishte sallë e bashkisë, e njësisë administrative, apo e një biznesi privat?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Z. I. Rusmali: Në raportimin që ata kanë bërë për aktivitetin, thonë “aktiviteti do të bëhet në një mjedis privat”. Salla është private.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Nuk është argumentuar.

Z. I. Rusmali: Bashkia duhet t'ju thoshte e ka marrë me qira, apo jo?

Znj. M. Koja: Nuk na e ka thënë këtë, pavarësisht se ua kemi kërkuar, nuk na u dha informacioni si është vënë në dispozicion salla, fonia, apo mjete të tjera që konstatohet se janë përdorur në atë aktivitet. Krahas këtyre sa thanë më lart ne kemi theksuar në vendim që prania e një deputeti në vetvete nuk e përbën të ndaluar. Deputeti, pavarësisht faktit në kuptueshmërinë tonë, pavarësisht faktit që nuk është deputet i asaj zone zgjedhore, duke qenë se ai ka një mandat imperativ, pasi merr mandatin, pasi hyn në Kuvend dhe merr karrigen e tij në Kuvend, ai mund të shkojë të kërkojë llogari për buxhetin, mënyrën si shpenzohen ato, që vetë parlamenti miraton, por vetëm fjala, sepse po të shikoni provat filmike dhe videot...

Z. I. Rusmali: Unë i kam parë.


Znj. M. Koja: Aty thuhet...

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje që ta kthejmë në shina dhe të mos e bëjmë debat teorik.

Znj. M. Koja: Aty thuhet “Banorë të kësaj njësie administrative që kanë mbështetur PS-në, ashtu do të jenë pararojë në zgjedhjet e 14 majit”. Pra, jemi në janar dhe flasim për 14 majin. Është e thënë tekstualisht kështu.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Ku qëndron shkelja në këtë rast?

Z. L. Braho: Më lejoni të bëj disa pyetje zoti Rusmali?! Tani kur bëjnë raportimet i kanë cituar emrat e deputetëve pjesëmarrës? Pra, që do të jenë të pranishëm edhe deputetët kur janë bërë raportimet, sepse ne nuk i kemi këto të dhëna të raportimeve.

Znj. M. Koja: Kanë thënë “nëse dëshirojnë deputetë mund të marrin pjesë”. Kështu është deklaruar pa i nominuar.

Z. L. Braho: Te raportimi apo te shkresat?

Znj. M. Koja: Te raportimi në ndërfaqe, “nëse dëshirojnë deputetë mund të jenë prezent”.

Z. L. Braho: Kush e dëshiron deputetin, sipas raportimit?

Znj. M. Koja: Kryetari i bashkisë deklaroi..., më saktë sekretari i përgjithshëm, jo kryetari i bashkisë, sepse detyra e tij është deklaroi që “pjesëmarrës janë kryetari i bashkisë, përfaqësues të njësisë administrative të Bashkisë së Fierit, nëse dëshirojnë deputetë mund të jenë prezent”. Pra, ata i kanë ftuar deputetët dhe nëse kanë dëshirë mund të jenë prezent.

Z. L. Braho: Tani me çfarë shoh unë objekti të paktën aktiviteti i parë është “komuniteti i njësisë administrative të Dermenasit ka paraqitur pranë njësisë një kërkesë me shkrim ku ka kërkuar një takim me kryetarin e bashkisë”. Këtu ka qenë i pranishëm edhe deputeti, zoti Taulant Balla. Tani te fjala e deputetit thuhet:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

“Bujqësia motor i zhvillimit të Fierit, Saliu shqetësohet për hallet e veta, 21 janarin dhe Gërdecin”. Tani, ka lidhje ky fjalim i deputetit me objektin e aktivitetit?

Znj. M. Koja: Unë e kam dëgjuar videon ai nominonte partinë së cilës i përket. Pra në lidhje me ato që ju thatë, por është përtej..., janë më gjatë. Këto që ju thatë, po janë pjesë e videos, unë i kam të zbardhura.

Z. L. Braho: Tjetra në takimin e Mbrostarit flitet...

Z. K. Bele: Ledio të lutem.. Dëgjova pak më parë Madalenën, tani kur themi deputetët, ministrat, apo ata që janë funksionarë publikë, se e kuptoj që ju thatë që biem të gjithë dakord. Unë e kuptoj që funksionarët, nëpunësit civilë, për shembull, sekretari i përgjithshëm nuk mund të shkojë atje dhe të flasë politikisht për arritjet “x” apo “y”. Nuk i lejohet në një aktivitet të institucionit. Pra, nëse do të ishte Bashkia e Fierit apo një bashki tjetër, sekretari i përgjithshëm nuk do të ishte personi që do të udhëhiqte fjalimet dhe të fliste për pjesën politike, por kryetari i bashkisë ose deputetët, apo ministrat unë nuk e di se për çfarë tjetër mund të flasin. Ata duke qenë funksionarë politikë ata flasin edhe për gjëra teknike, por nuk e di si do të ndahet me thikë kjo në konceptin..., sepse kam përshtypjen se po ecim për herë të parë ndoshta në këtë lloj detaji. Unë e kuptoj qëllimin e ligjvënësit që ka dashur të kufizojë përdorimin e burimeve, por shoh një diferencë në mes përdorimit të burimeve dhe lirisë apo të drejtës së funksionarit politik për të folur politikisht. Pra, unë nuk e kuptoj dot se si mund të jetë më buton kur flet politikisht dhe kur flet teknikisht funksionari politik.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Për të sjellë në vëmendjen tuaj nëse mund të na ndihmojë në kuptueshmërinë e kësaj që po shqyrtojmë, ne kemi pasur edhe denoncime të tjera ose indicie për kryetarë të tjerë bashkish. Janë vendime të publikuara të Komisionerit. Është rasti i Bashkisë së Elbasanit, apo do të publikohen, ku ka pasur pjesëmarrës, deputet. Ka qenë takim elektorale, në bindjen tonë. Nuk është raportuar në ndërfaqe. Ai është një takim me elektoratin e partisë. Kanë qenë pjesëmarrës deputetë, kryetari i bashkisë, në një ambient privat, janë shpenzime të partisë. Sigurisht i mban KQZ-ja shënim, po themi në një kuptim tjetër, por në vlerësimin tonë ata kanë bërë fushatën e tyre jo detyrimisht në funksion të zgjedhjeve. Ato janë takime që mund të jenë dhe periodike, por nuk janë veprimtari të kryetarit të bashkisë në funksionin e tij, por janë takime të tij si një person politik. Ai mund të mbajë një post politik në parti dhe vazhdon jetën e tij politike. Në fakt, ajo që ju ngrini është shumë e drejtë, ka një konfuzion edhe nga vetë titullarët dhe ne po e hasim gjithmonë e më shumë. Ne po verifikojmë në ndërfaqe raportime të veprimtarive politike, të forumeve rinore, për shembull. Po të shohim faqen, kemi raportime të veprimtarive politike, që nuk janë veprimtari që duhen raportuar në KQZ, në fakt. Pra, ka një problem në kuptueshmëri nga të gjithë dhe ne jemi të ndërgjegjshëm për këtë gjë. Para pak ditësh ne kemi bërë një kujtesë mbi çfarë është veprimtari institucionale dhe do të raportohet dhe çfarë është politike elektorale dhe nuk ka nevojë të raportohet dhe si do të qaset ajo. Sapo ta kemi të konsoliduar, po konsultohemi edhe me aktorë të tjerë, me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në Shqipëri të interesuara për zgjedhjet, do t'ia shpërndajmë të gjitha institucioneve për t'i mirorientuar. Pa dyshim kryetari i bashkisë, sidomos në rastin kur ai rikandidon, ai do të bëjë fushatë patjetër, por ai duhet të ndajë mirë momentin kur do të bëjë fushatë me elektoratin dhe takim të raportuar në KQZ në përmbushje të detyrave të tij funksionale. Duhet ta bëjë këtë ndarje. E kërkon Kodi.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. L. Braho: Pra, në atë konceptin tuaj duhet ndarë kur kryetari i bashkisë merr pjesë në fushatë elektorale dhe organizon një aktivitet si kandidat, apo edhe kur deputetë të ndryshëm mund ta ftojnë për të marrë pjesë, në ndryshim kur një takim kërkohet nga komuniteti Ndërmenas për aktivitete të bashkisë dhe shkon një deputet dhe bën fushatë elektorale. Për më tepër edhe nga fjalët e deputetëve duket që nuk ka lidhje me komunitetin Ndërmenas as kjo aleanca e rublave Berisha-Meta apo Gërdeci. Megjithatë, unë nuk kam pyetje tjetër, e kuptova konceptin tuaj në lidhje me këtë, nuk e di kolegët.

Z. K. Bele: U bëra kurioz dhe po shoh datën e aktivitetit të parë, unë shoh që kjo është 4 shkurt. Kjo datë është ditë e shtunë, ditë pushimi.

Znj. M. Koja: Është zhvilluar, me sa raportohet, më 4 shkurt, po ai në Mbrostar, ndërsa të tjerat janë raportuar në datën 25 për t'u zhvilluar më 28 janar. Këto janë datat e aktiviteteve.

Z. K. Bele: Unë në kuptueshmërinë time, se nuk ka ndonjë herezi që duhet të pranojmë që ndryshimet në ligj, bie dakord me këtë që thoni, patjetër që duhen kohë të kuptohen. Ka edhe raste që ndryshimet në ligj rindryshohen, pra ligji është dinamik, ndryshon, ka edhe ligje që shpallen antikushtetuese apo për arsye të ndryshme bëhen ndonjëherë edhe të pazbatueshme apo krijohen konflikte ligjore që bëhen pjesë e sistemit në mënyra të ndryshme. Unë kam përshtypjen, pa hyrë në debat teorik, ajo që ne kemi konstatuar edhe në rastet e mëparshme, nevoja dhe rregullimi ligjor që detyron bashkitë ose institucionet të raportojnë ka sjellë një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

raportim të detyrueshëm. Pra, ata janë ndodhur midis dy zjarreve, po nuk raportuan, do të gjobiten, po raportuan, janë në riskun që çfarëdo që të thonë mund të bjerë ose jo brenda konceptit politik. Një aktivitet që zhvillohet ditën e shtunë, ku shkon një kryetar bashkie me një apo PR-in e tij dhe ndoshta nuk paguhet për atë ditë dhe shkon apo jo me mjetet e veta, jo domosdoshmërisht duhet raportuar. Unë kam përshtypjen që po raportohen aktivitete që... Bashkitë, e kam gjenerale këtë, të ndodhura në këtë situatë po raportojnë edhe aktivitete, ne kemi parë që raportojnë mbledhje të këshillit bashkiak pra, këtu raportohet gjithçka. Nga ana tjetër ne pranojmë që në këto aktivitete publike mund të vijnë edhe deputetë dhe patjetër që deputeti do të flasë politikisht e nuk do të flasë për përmasat e kanalit vaditës. Atëherë ne futemi në një rreth vicioz, ku çdo aktivitet, nëse e sheh me lupë, bëhet aktivitet që me këtë filtër që keni vendosur dhe me këtë standard që vendosni ju, çdo aktivitet është i tillë, pra që është vendosur duke e parë. Ne e marrim të mirëqenë që kryetari i bashkisë ka shkuar me makinë, por nuk e dimë është makinë e tij, është makinë e institucionit. Ne themi është përdorur projektor, por projektorin mund ta ketë pasur ai djali që e ka sjellë ose mund ta ketë pasur lokali. Ne këto nuk i dimë, ne i marrim të mirëqena dhe krijohet përshtypja që këta janë të gjithë shkelës apriori të ligjit pse zhvillojnë aktivitete. Aktivitete janë zhvilluar e do të zhvillohen.

Znj. M. Koja: Nuk u provua asnjë nga këto prova, vetëm veprimtaria institucionale e vendosur në shërbim sikurse përcakton vendimi nr.9. Ato nuk janë të provuara.

Z. K. Bele: Kemi dy palë në proces politik. Njëra palë që është pala brenda institucioneve, mund ta quash edhe në pushtet, e cila flet, sipas saj, për arritjet, dhe është pala tjetër, sipas tyre, që flet për dështimet. Palës që flet për dështime nuk i vihen kufizime, se nuk kanë vendosur ligjvënësit. Është bërë kujdes te burimet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


publike. Por në këto aktivitete, ku takohen disa veta, në një sallë private, unë nuk e di pse duhet raportuar ai aktivitet, në një ditë pushimi.

Znj. M. Koja: Vetë kryetari i bashkisë, pavarësisht se është ditë pushimi, e ka konsideruar aktivitet të bashkisë me stafin e bashkisë për të monitoruar problematikat e tematikës që kanë raportuar. Na u krijua bindja që është veprimtari e kryetarit të Bashkisë Fier, nga sa kanë raportuar ata vetë. Me të drejtë ju thoni që raportohen edhe mbledhjet e këshillit bashkiak dhe ne u kemi bërë thirrje dhe i kemi përjashtuar nga detyrimi, nuk raportohet mbledhja e këshillit bashkiak...

Z. K. Bele: Bashkia është pushim ditën e shtunë, përveçse kur ka një situatë të caktuar, nuk e di, të shtunën paradite bashkia nuk para është në punë. Ata e kanë raportuar si të tillë, por kam përshtypjen që është krijuar një konfuzion dhe ju do të duhet të rishikoni ose duhet të punoni, sepse kjo është një situatë që ne nuk komunikojmë. Ne këtë proces marrim produktin sigurisht të ligjit, nuk kemi fuqi ta ndryshojmë dhe të akteve rregullatore. Të cilat janë në një situatë që vërtet i miraton Komisioni Rregullator, por ndryshimet e nevojshme propozohen nga administrata e KQZ-së ose draftet eventuale. Ne kemi një situatë, o e kapim këtej, o e kapim andej, dhe nuk ka qenë ky qëllimi i ligjit, mendoj unë.

Z. L. Braho: Një pyetje tjetër. Në qoftë se te raportimi i aktiviteteve do të citohej edhe tematika e fjalës së deputetëve, sipas rastit, a do të konsideroheshin këto aktivitetet të ndaluara për KQZ-në? Pra, në aktivitet do të thuhej që është i pranishëm edhe deputeti Taulant Balla, i cili do të flasë për çështjen e Gërdecit, do të ishte ky aktivitet i ndaluar?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Për t'ju dhënë një informacion, jo më larg se mbrëmë janë ndaluar rreth 10 veprimtari të disa bashkive: Cërrik, Lushnjë, ku në raportim ishte përfaqësues politik i qarkut. Ne i kemi ndaluar këto veprimtari, duke filluar që dje. Në qoftë se ata do të thonë që është përfaqësuesi politik, do të jetë veprimtari e ndaluar. Ndërsa pyetja juaj ishte tjetër. Është përcaktuar tematika e diskutimit, atëherë do të vlerësohej rast pas rasti.

Z. L. Braho: Këto raste do të ndaloheshin vetëm prej përfaqësuesve politikë, në qoftë se do të deklaroheshin përfaqësuesi politik, pavarësisht fjalës.

Znj. M. Koja: Ne përpara se të arsyetonim, u konsultuam me Rregulloren e Kuvendit, ligjin për statusin e deputetit, pa dyshim Kushtetutën, kompetencat që ai ka, prandaj u përpoqëm të ishim të kujdesshëm edhe në atë që analizuam dhe propozuam.

Z. L. Braho: Në rregull. Faleminderit! Nuk kam pyetje tjetër.


Z. I. Rusmali: Pse e ndaloni ju një aktivitet ku marrin pjesë përfaqësues politikë?

Znj. M. Koja: Sepse është një takim i bashkisë dhe përfaqësuesi politik i një force shkon atje për të bërë fushatë, për të bërë promovim të partisë së tij.

Z. I. Rusmali: Pse e ndaloni ju?

Znj. M. Koja: Sepse është vendosje, pra nuk mund të shfrytëzohet veprimtaria institucionale në shërbim të një force politike.

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Nuk thotë kështu ligji, nuk thotë kështu vendimi nr.9.

Znj. M. Koja: Vendimi nr. 9...

Z. L. Braho: Mund të themi që cenon parimin e barazisë së garës?

Znj. M. Koja: Mund ta lexoj. “Organizojnë menjëherë punën dhe marrin masa të menjëhershme për garantimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore për ndalimin e vënies në përdorim të subjekteve zgjedhore, ndër të tjera të veprimtarisë së tyre institucionale.” Për më tepër në shkronjën “ç” thuhet, prapë detyrat e kryetarëve të bashkisë: “Kanë për detyrë të verifikojnë, të analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve, materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale gjatë periudhës para fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale dhe marrin masa”. Pra, vetë kryetari i bashkisë ka detyrë të marrë masa, “për përcjelljen e denoncimeve sipas rastit në KQZ ose në prokurori në kuptim të nenit 328, shkronja “a”, “Përdorimi i funksionit publik” për veprimtari publike ose zgjedhore”. Pra, vetë kryetari i bashkisë e ka për detyrë të monitorojë administratën e tij...

Z. I. Rusmali: Kjo është detyra e tij. Ju keni ndaluar mbi informacionin që në veprimtari do të marrin pjesë edhe politikanë. Ju ndaloni në rastet e përcaktuara nga kuadri juaj ligjor dhe ju ndaloni në rastet kur ju konstatojnë që në prezencë të publikut po keqpërdoren burimet publike. Këtë ju thotë ligji, vetëm keqpërdorimin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

burimeve publike ju e ndaloni. Tani, ku është keqpërdorimi te informacioni merr pjesë politikani?

Znj. M. Koja: Është folës.

Z. I. Rusmali: Flet dhe flet llogorenë e vet politike, pa diskutim, po ku është këtu ndalimi, sepse ndalimi duhet të jetë ligjor, thuhet “keqpërdorimi i burimeve shtetërore shkak për ndalimin”.


Znj. M. Koja: Veprimtaria institucionale e kryetarit të bashkisë, vendimi nr. 9, në nenin 7, pika 1, shkronja “a” flet për veprimtarinë e tyre institucionale, të mos vihet në funksion të partive politike. Funkcionari politik i përket partisë politike, kështu që kjo është kuptueshmëria jonë.

Z. L. Braho: Pra, ideja është që në momentin që është një veprimtari institucionale, shpenzohen burime ose konsumohen burime shtetërore, sepse nuk besoj se mund të ketë ndonjë aktivitet me zero kosto, qoftë kjo edhe përdorimi i burimeve njerëzore, ndaj ju e konsideroni si vënie në dispozicion të aseteve publike për një fushatë elektorale.

Z. I. Rusmali: Me deduksion kjo punë.

Z. L. Braho: Nuk është deduksion, është e njëjta teori që ne ndoqëm edhe për kandidatët, që nuk mund të bësh fushatë pa lekë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Neni 7 bën fjalë për detyrat e sekretarëve të përgjithshëm dhe drejtuesve të institucioneve publike të pavarura e të varësisë. Është nen që përcakton detyra. Ju referencë keni nenin që përcakton veprimtaritë e ndaluara. Pse nuk lexoni atë, po lexoni nenin që përcakton detyrat? Sepse për të shkuar që është një veprimtari e ndaluar ose jo, do shkosh te përkufizimi i veprimtarisë së ndaluar, jo te detyrat e sekretarit të përgjithshëm. Pse nuk shkoni atje? Në qoftë se do t'ju duhet të thoni që ka rrezik për keqpërdorim të burimeve shtetërore, do të shkoni te përkufizimi i burimeve shtetërore, nuk do të shkoni ke funksionet e kryetarit të bashkisë, se nuk lexohet ashtu ligji.


Znj. M. Koja: Ne shkojmë te neni 91, pika 1 dhe pa dyshim dalim te diskutimi juaj në krye të herës për fushatën zgjedhore. Pra, ndalimi i burimeve në fushatë zgjedhore dhe specifikisht neni thotë që “Ndalohet me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje..”, pra në zgjedhje, e ka të përgjithshme, “..burimet e organeve apo enteve publike”, dhe më pas vijojmë me kuptueshmërinë e burimeve. Burimet cilat janë? Janë sendet, asetet...

Z. I. Rusmali: Organi nuk është burim, apo jo?

Znj. M. Koja: Është bashkia, janë punonjësit e bashkisë.

Z. I. Rusmali: Janë sendet, jemi dakord që janë sendet dhe sendet që i përkasin shtetit nuk mund të vihen në dispozicion të fushatës. Këtë thotë ligji.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Sendet dhe burimet njerëzore dhe burimet njerëzore i lidh vetëm me fushatën ...

Z. I. Rusmali: Burimet njerëzore janë nëpunësit e institucionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I detyruar dhe në orar të punës.

Z. L. Braho: Ai shkon për aktivitet të bashkisë dhe detyrohet të dëgjojë premtime elektorale. Ky është po të themi përdorimi i detyruar.

Z. I. Rusmali: Nuk ka lidhje me politikanin që merr pjesë në një aktivitet.

Z. L. Braho: Politikani në këtë rast shfrytëzon, por nuk është ai burimi, nuk është ai sendi. Politikani shfrytëzon sendet e bashkisë në këtë rast. Të paktën unë kështu e kuptoj, aktivitet që organizohet nga bashkia, ti shkon si politikan e mban fjalime politike. Ky është edhe qëllimi i nenit 91 dhe vetë qëllimi i rregullores së miratuar nga Komisioni Rregullator.

Z. I. Rusmali: Të bëj një pyetje: Tek të tria episodet e Bashkisë Fier, dua përgjigje për të tria, pse sipas jush ato nuk janë veprimtari publike propagandistike, politike propagandistike, por janë veprimtari publike elektorale? Pse janë elektorale dhe nuk janë propagandistike?

Znj. M. Koja: Nuk janë propagandistike të punës së bashkisë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Propagandistike të politikës të çfarë të duash ti, veprimtari politike, është edhe aty puna e bashkisë. Ne që e kemi parë videon e dimë që kryetari i bashkisë ka raportuar vetëm për punën e vet aty, ka raportuar për atë që ka kryer, madje në terma të përgjithshëm. Nuk ka thënë në terma të përveçëm kemi ndërtuar këtë rrugë, këtë rrugë, por ka thënë kemi ndërtuar kaç kilometra rrugë. Ka raportuar sigurisht edhe për planet e bashkisë për të ardhmen, përsëri në termat e përgjithshëm. Pra, ai është në kuadër të lëndës së takimit, e ka bërë këtë punë, por ky është aktivitet politik gjithsesi, se politik është ai.

Znj. M. Koja: Të flasim për politikën e bashkisë.

Z. I. Rusmali: Kryetari i bashkisë është institucion politik, se kështu është dhe kur flet për politikë është në ushtrim të funksioneve të veta. Unë dua ta ndaj, sepse mendoj që mund të na ndihmojë në arsyetim, mund të mos jetë shumë e rëndësishme. Jemi përpara një veprimtarie politike, apo propagandistike, se qartazi propogandistike, apo jemi përpara një veprimtarie elektorale? Ndoshta ligjërisht trajtohen në mënyra të ndryshme. Tani diçka duhet t'i ndajë këto të dyja, njërin nga tjetra. Çfarë i ndan në kuptimin tuaj?

Znj. M. Koja: Në kuptimin tonë ajo është një veprimtari, në rregull ju e quani propagandistike, për mua është veprimtari e një kryetari bashkie, i cili shkon e jep llogari në lidhje me mënyrën e administrimit të buxhetit të tij, të bashkisë. Si janë shpenzuar, sa kilometra rrugë janë ndërtuar? Çfarë do të bëjë ai me atë buxhet të miratuar për vitin 2023 në funksion të këtyre dy njësive administrative, Ndërmenas dhe Topojë. Pra, ai i flet ...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. K. Bele: Ne patëm edhe raste të disa bashkive të tjera, që për shkak të asaj që unë e quaj mbiraportimin, ose keqkuptimin me raportimin, siç janë raportuar aktivitetet që janë funksionale të bashkisë dhe nuk kanë asnjë lloj impakti. Ishe një në Durrës, dy veta shkojnë në një aktivitet arbëresh në Itali, se çfarë lidhje ka kjo që shkojnë dy veta nga bashkia te aktiviteti i arbëreshëve?! Kjo është ta bësh qesharak ligjin, duke dashur të jesh në rregull me ligjin. Është edhe keqkuptimi tjetër, që e ngriti Ilirjani, që ka të bëjë me raportimin e aktiviteteve politike si aktivitete të bashkisë. Kur ti sheh që ata mblidhen të shtunën apo të dielën në darkë, mbasdite apo paradite dhe raportojnë në komunitet, në fakt, raportimi është politik, se komuniteti nuk voton aty. Pra, kur kryetari flet për raportimin për çfarë ka bërë bashkia, ai është aktivitet politik.

Znj. M. Koja: Në rastin konkret ata kanë thënë që kanë qenë vetë të interesuar për pakënaqësinë që mund të kenë apo informacion që kërkojnë të kenë më tepër banorët e njësive administrative, është një llogaridhënie në një farë mënyre, të paktën në kuptueshmërinë tonë. Ka shkuar të japë llogari për mënyrën e menaxhimit të fondeve...

Z. K. Bele: Llogari politike, se nuk ka asnjë raport ligjor...

Znj. M. Koja: Për transparencën e fondeve ka një ligj sesi bëhet transparenca e fondeve nga një institucion dhe nga titullari i institucionit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. K. Bele: Në qoftë se në ligjin për pushtetin vendor ka ndonjë detyrim organik që kryetari jep llogari përpara komunitetit dhe kjo është ushtrim i funksionit të tij publik jashtë orarit zyrtar, mund ta kem unë gabim.

Znj. M. Koja: Mbrostari është jashtë orarit zyrtar se të tjerat janë brenda orarit zyrtar. Normalisht, në dijeninë time, aq sa dimë ne, institucionet japin llogari për mënyrën si menaxhojnë fondet, kryesisht për investimet që bëjnë në zona të caktuara. Ne e kemi kuptuar kështu si një llogaridhënie dhe sqarim si do të menaxhohen fondet për vitin 2023, buxhetin e vitit 2023. Ne kështu e kemi kuptuar dhe e kemi gjetur me vend e ta vlerësojmë si veprimtari publike përpos asaj që e ka kategorizuar vetë Bashkia Fier si veprimtari publike. Ne kemi bindjen që ajo është veprimtari publike, institucionale e Bashkisë Fier dhe është keqpërdorur në një moment të caktuar. Pra është *post factum* i vërtetuar kjo gjë, prandaj jemi edhe sot këtu.


Z. L. Braho: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Jo, nuk kam pyetje.

Z. L. Braho: Zoti Lako.

Z. E. Lako: Meqë e bëmë si debat këtë, shkurtimisht, nëse te ky aktivitet do të vinte një politikan tjetër i krahut të opozitës dhe do të shante këtë punë të bashkisë, atëherë ky kryetari i bashkisë përsëri do të mbante përgjegjësi?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Pyetja është me vend, në fakt, po të kemi një rast të tillë do t'i vlerësojmë me kujdes të gjitha rrethanat dhe faktet, sepse ai e ka ftuar, nuk është e njëjta situatë, është i ftuar. Pra, ka ftuar deputetë.


Z. E. Lako: Ndaj po them, meqë e ka ftuar, mund të vinte edhe ai tjetri se ka qenë i ftuar.

Znj. M. Koja: Në çdo rast, edhe po të kishte ardhur deputet i krahut të kundërt, do të kthehej në një arenë debati politik, prandaj duhet të kenë kujdes të shtuar, kryetarët e bashkive, në këtë periudhë. Dhe për veprimtari të ndaluara që janë ndaluar mbrëmë, sot kemi komunikime të vazhdueshme që duam t'i zhvillojmë pa prezencë politike. Do të vlerësohen në vazhdim, pra ndërgjegjësimi vazhdon.

Z. L. Braho: Nuk po ndalojmë politikën, po ndalojmë politikën në aktivitetet institucionale, të paktën unë kështu e kuptoj. Çdo deputet, çdo drejtues qarku ka gjithë të drejtën të bëjë aktivitete politike 24 orë në ditë në çdo cep të Shqipërisë. Por jo të shfrytëzojë një aktivitet të bashkisë për të bërë një aktivitet politik. Për mendimin tim, edhe në qoftë se do të ishte i opozitës, patjetër duhet të jetë aktivitet i ndaluar, sepse nuk mund të shfrytëzohet për politikë nga asnjë palë.

Z. E. Lako: Një sqarim këtu, tamam e kthjem në debat, ishte ideja që është tjetër gjë se çfarë duhet të jetë dhe është tjetër gjë për objektin që gjykojmë, për përgjegjësinë e kryetarit të bashkisë. Pra, a do të kishte përgjegjësi kryetari, sepse në një aktivitet dikush flet pro apo kundër për një aktivitet të ndaluar? Pra, të marrë pjesë një deputet në një aktivitet nuk është e ndaluar, është normale, në qoftë se dikush flet pro apo kundër, është përgjegjësia e kryetarit në të dyja qasjet?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. Y. Merkaj: Po, si organizatori i takimit është përgjegjës, duhet të ketë dijeni për tematikën e fjalimit.

Z. E. Lako: Mbase do t'i bëhet me dije atij dhe të marrë miratimin e tij.


Znj. M. Koja: Flasim për situata të paparashikueshme pastaj.

Z. L. Braho: Vazhdojmë me rastin e Bashkisë Përrenjas që ka një veprimtari publike, që është me denoncimin nr. 128, ka zhvilluar veprimtari publike të pa raportuar në faqen e KQZ-së. Pra, këtu jemi në kushtet që edhe nuk është raportuar, edhe që ka qenë pjesëmarrës një drejtues politik, në këtë rast zoti Gjikhuri. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie është postuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë, zotit Nuri Belba dhe ka këtë përmbajtje: “Së bashku me Damianin bashkëbiseduam me pensionistë dhe veteranë të Përrenjasit. Qeveria ka treguar vëmendje të veçantë ndaj moshës së tretë, duke ofruar përkujdesje dhe mbështetje jo vetëm për shpërblimin e fundvitit, por edhe bonusin e pakos së madhe”. Fjalën e ka zoti Merkaj për këtë rast.

Z. Y. Merkaj: Bashkia Përrenjas ka kryer një veprimtari të regjistruar me nr.128 ID, ku në datën 22.2.2023 ka zhvilluar një veprimtari publike të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së. Pjesëmarrës ka qenë drejtuesi politik i Qarkut të Elbasanit. Për zhvillimin e kësaj veprimtare publike është postuar në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë Përrenjas, zoti Nuri Belba.

Z. L. Braho: Është raportuar?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. Y. Merkaj: Po. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se kjo veprimtari është raportuar në ndërfaqen e raportimeve në datën 12.2.2023. Për sa i përket pjesëmarrjes së zotit Gjikhuri në këtë veprimtari, duhet të sqarojmë që referuar Kushtetutës dhe statusit të deputetit, deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike, që ka me të gjitha organet qendrore dhe vendore. Pjesëmarrja e tij në aktivitetin e organizuar nga kryetari i bashkisë, ky është arsyeimi i Komisionerit, nuk e kthen aktivitetin në një takim elektorale. Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë. Megjithatë, këto takime nuk duhet të shfrytëzohen për thirrje elektorale apo për të përcjellë mesazhe me një përmbajtje të tillë. Të ndodhur në këto kushte, ku jemi në një periudhë zgjedhore, kryetarët e bashkisë si organizatorë të takimeve të mësipërme kanë pasur detyrimin për të përcaktuar objektin dhe tematikën e diskutimit për folësit në takim. Kjo është përgjigja që dhamë pak më parë që kryetari i bashkisë është përgjegjës për të gjithë axhendën dhe tematikën. Duke qenë se ka shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri i propozon KAS-it të marrë masë administrative gjobë në masën 10 mijë lekë për kryetarin e Bashkisë Përrenjas.

Z. L. Braho: Unë kam një paqartësi, këtu thuhet që aktiviteti është pasqyruar në media dhe thirrje kanë bërë të dy zyrtarët, si zoti Nuri Belba dhe zoti Damian Gjikhuri dhe është cituar vetëm fjala e vetë kryetarit të bashkisë, që thotë: “ Qyteti brenda katër vjetëve ishte transformuar duke njohur investime të rëndësishme falë edhe mbështetjes së qeverisë socialiste”. Ndërkohë më poshtë është bërë edhe arsyeimi që ju sapo cituat që nuk është ndalim në vetvete fakti që ka qenë deputeti

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

i pranishëm. Në këtë rast, dënimi administrativ parashikohet për vetë fjalën e kryetarit të bashkisë?

Znj. M. Koja: Në fakt, është për të dyja rastet, vlen të bëhet analogjia edhe me atë që diskutuam më herët, dhe kjo është një veprimtari e deklaruar e raportuar në KQZ me pjesëmarrje të punonjësve të bashkisë, siç ka raportuar edhe vetë Bashkia Përrenjas. Gjatë fjalimeve, ligjëratave të folësve kryesorë, si të deputetit dhe të kryetarit të bashkisë ka konotacion politik. Fjala e tyre ka përmbajtje politike, por në mënyrë të spikatur është ajo e deputetit pjesëmarrës i cili ka thirrje politike të shprehur haptazi. Për këtë arsye ne jemi sot dhe propozojmë sanksion ndaj kryetarit të bashkisë për të dyja pyetjet që ju bëtë.

Z. L. Braho: Unë përsëri nuk e gjej në kërkesë se çfarë ka thënë deputeti për Përrenjasin, për Librazhdin ka diçka. Ka vetëm çfarë ka thënë kryebashkiaku, kështu që besoj se duhet një provë shtesë. Zoti Merkaj...

Znj. M. Koja: Në fakt, është një video, ndaj na duhet të transkriptojmë videon, dhe ta sjellim si provë të administruar nga ata që hetojnë në rastin konkret.

Z. L. Braho: Ka pyetje nga kolegët për rastin e Përrenjasit?

Z. I. Rusmali: Analiza është e ngjashme dhe ndoshta edhe pyetjet përsëriten. Në vendimin nr. 201, Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit për shkak se kryetari i Bashkisë Përrenjas nëpërmjet lejimit të mbajtjes së fjalimit me përmbajtje

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

elektorale, ka përdorur burime publike të organit që ai drejton në dispozicion të fushatës elektorale. Mund të na i identifikoni se cilat janë këto burime publike?

Znj. M. Koja: Nga sa konstatohet nga hetimi administrativ, veprimtaria është zhvilluar në një ambient privat, pra nuk është ambient i bashkisë apo i ndonjë njësie administrative tjetër. Edhe gjatë këtij hetimi nuk u provua dot se si janë vënë në dispozicion fondet për përdorimin e këtij ambienti, pra, është marrë me qira, apo i dhuruar, por në çdo rast ne mendojmë që qoftë burim i bashkisë, pra do të thotë aset i bashkisë apo i vënë në dispozicion të bashkisë, ajo është para. Paraja është send jo vetëm në kuptimin ekonomik, por edhe juridik të fjalës. Në këtë kuptim e kemi pasur burim.

Z. I. Rusmali: Nuk e keni identifikuar burimin e përdorur në këtë rast.


Znj. M. Koja: Në vendimmarrje mund të jetë mos artikulluar kështu siç unë e thashë, por kjo ka qenë kuptueshmëria jonë.

Z. K. Bele: Vetëm fakti që shkon kryetari në një aktivitet dhe raporton, merret e mirëqenë që janë përdorur burime publike, se këtë nuk po kuptoj?

Znj. M. Koja: Jo, nuk është vetëm kryetari, janë edhe punonjësit e bashkisë në aktivitet si pjesëmarrës dhe kjo është e provuar.

Z. K. Bele: Po mundohem ta shoh në *facebook*, me thënë të drejtën.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Koja: Mund t'ju vë në dispozicion raportimin që ka bërë vetë Bashkia Përrenjas. Ju e keni te provat që ju janë vënë në dispozicion, në njoftimin që është bërë në ndërfaqe.

Z. K. Bele: Pra, është hetuar ky moment që ka pasur persona të tjerë që shoqëronin kryetarin e bashkisë në kryerjen e këtij aktiviteti. Varet, mund të jenë persona që nuk e kanë të ndaluar të marrin pjesë.

Znj. M. Koja: Janë punonjës të bashkisë në orar zyrtar.


Z. K. Bele: Këtu nuk pasqyrohet dhe ora.

Z. I. Rusmali: Nga fotot që shoh unë, thuhet që takimi është me pensionistët, apo jo, është ky? Takimi është me tematikë pensionistë dhe kanë folur për arritjet e mëdha në fushën e pensioneve. Nuk ka nevojë për ekspertizë, nga fotot kuptohet qartë që njerëzit janë të moshës së tretë. Vetëm ata të podiumit, por ata janë paria, nuk besoj se janë punonjësit e bashkisë.

Znj. M. Koja: Një pjesë prej tyre janë punonjës të bashkisë.

Z. I. Rusmali: I njihni? Se zakonisht në podium vihen miqtë e nderuar që na vijnë në këto raste. Kështu është rregulli i podiumeve. Damiani, për shembull. Nuk shkojmë dot më tutje se sa kaq.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. L. Braho: Vazhdojmë me rastin tjetër, Bashkia Librazhd. Një denoncim regjistruar me nr. 4 ID. Bashkia Librazhd ka raportuar fillimisht datën 16 janar 2023 ndërfaqe një aktivitet, më pas ka zhvilluar një aktivitet publik në datën 18 janar, me temë “Takim me pensionistët”. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe zoti Damian Gjikhuri. Aktiviteti është pasqyruar në disa media, një prej të cilave televizioni kombëtar Klan TV. Në fjalën e mbajtur, zoti Gjikhuri ka bërë qartazi fushatë elektorale, duke thënë shprehimisht: “Zgjedhjet duam t’i fitojmë, jo thjesht për të mbajtur flamurin e pushtetit, sepse Partia Socialiste ka fituar gjithmonë në Librazhd. Qeveri-bashki të jemi një”. Zoti Merkaj, ndonjë shtesë në lidhje me këtë rast?

Z. Y. Merkaj: Jemi në të njëjtat kushte si në rastin e Bashkisë Përrenjas. Kryetari i Bashkisë duhet të kishte marrë masat që drejtuesi politik i qarkut s’duhet të kishte marrë pjesë, ose të paktën tematika të ishte brenda institucionit të bashkisë, kanë dalë jashtë tematikës, është bërë fushatë elektorale, kështu që është propozuar për gjobë 10 mijë lekë. Faleminderit!

Z. L. Braho: Dakord. Faleminderit! Ka ndonjë pyetje për këtë?


Z. Y. Merkaj: Kemi edhe përfaqësuesin e Bashkisë Librazhd.

Z. L. Braho: Për rastin e Librazhdit kemi edhe përfaqësuesin e Bashkisë Librazhd, i cili është personi përgjegjës për raportimet. Fjala është për ju.

Përfaqësuesi i Bashkisë së Librazhdit: Përshëndetje! Për sa i përket takimit, takimi është raportuar në mënyrë të rregullt, sipas rregullores ose përcaktimeve të Kodit Zgjedhor për mënyrën e raportimit. Është raportuar nga unë si personi përgjegjës

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

dhe i caktuar nga kryetari i bashkisë për raportimet e aktiviteteve në kuadër të punës së bashkisë ose aktiviteteve të tjera jo të ndaluara. Raportimi është kryer i rregullt, me orarin kur do të zhvillohej, vendin, pjesëmarrësit dhe natyrën e të folurit. Në takim nuk kanë qenë punonjës të bashkisë, por kanë qenë pensionistë ose persona të moshës së tretë, në prag pensioni ose në pension dhe ka qenë pjesëmarrës edhe deputeti, përfaqësuesi politik i Qarkut Elbasan, ku kanë mbajtur edhe fjalimet përkatëse. Kryetari i Bashkisë ka folur lidhur me investimet që ka bërë Bashkia Librazhd, që u vijnë në ndihmë të moshuarve, si parqe ose kënde çlodhëse, ku ata mund të kalojnë kohën e tyre. Ndërsa deputeti, përveç fjalëve lidhur me investimet e bashkisë, ka folur edhe për arritjet në lidhje me rritjen e pensioneve dhe politikën e qeverisë në ndihmë të pensionistëve. Ky ka qenë fokusi i takimit. Besoj se takimi është i rregullt, përtej ndonjë fjale.

Z. L. Braho: Kur keni bërë raportimin, meqenëse e keni bërë ju raportimin, e keni cituar një nga pjesëmarrësit dhe drejtuesin politik?


Përfaqësuesi i Bashkisë së Librazhdit: Në dijeninë time po, Në fakt, sot unë isha përgatitur, sipas email-it kemi edhe një rast tjetër, për rastin tjetër, por po diskutohet rasti i janarit. Mendova se ishte rasti i marsit.

Z. L. Braho: Nuk e di KQZ-ja mund të na i konfirmoni? Në qoftë se ka qenë i raportuar, pse nuk është ndaluar si aktivitet, apo është ndaluar dhe...

Znj. M. Koja: Jo, nuk është ndaluar. Është një veprimtari e raportuar më 16 janar 2023, pra vetëm 3 ditë pasi është hapur portali dhe detyrimi ligjor për të raportuar.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Është aktivitet ndërgjegjësues dhe informues me pensionistët. Folës kryesorë janë Kastriot Gurraj dhe Damian Gjiknuri. Është raportuar kështu.

Z. L. Braho: Në qoftë se është raportuar kështu dhe sipas përgjigjeve që dhatë më parë duhet të ishte ndaluar, meqenëse është një drejtues politik.

Znj. M. Koja: Jo, është deputet.


Z. L. Braho: Pra, duhet ta shkruajnë drejtues politik që të jetë i ndaluar, me deputet jo.

Znj. M. Koja: Vetëm ta shkruajnë, ideja është roli i tyre aty, çfarë flasin dhe çfarë propagande bëjnë aty. Nëse shkojnë në funksionin e deputetit që monitoron punën e kryetarit të bashkisë në raport me detyrat që ai ka, kjo është veprimtari normale dhe mund të ndodhë në çdo kohë, në çdo periudhë të vitit. Ndërkohë, nëse në këtë periudhë, shkojnë dhe shfrytëzojnë deputetët veprimtarinë publike të institucionit, bashkisë, për të bërë thirrje për të votuar në një mënyrë të caktuar, atëherë kjo e bën këtë veprimtari politike dhe në shërbim të politikës.

Z. K. Bele: Tani po bëhemi edhe kurioz. Me sa kuptova drejt, nëse kryetari i bashkisë e deklaroi aktivitetin të mbyllur dhe pastaj njerëzit bashkëbisedojnë aty, qofshin deputetë të cilitdo krah, nuk kemi ndalim.

Znj. M. Koja: Veprimtaritë publike janë ato të cilat kanë për qëllim të informojnë publikun rreth përmbajtjes së tyre, bëhen në prani të njerëzve ose të medias. Këto

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

janë veprimtari. Në qoftë se ajo është veprimtari e mbyllur e tyre, atëherë ajo nuk është më veprimtari publike.

Z. K. Bele: Një veprimtari që kryetari i bashkisë “x” ka vajtur në komunitet e ka folur për investimet në zonë, ka folur në kuadër të bashkisë. Mbaron veprimtaria, e mbyll fjalimin teknik ai, ai ndërkaq është edhe kryetar bashkie, kandidat ose jo, ai ose të tjerë në përfundim të veprimtarisë së bashkisë mund të vazhdojnë punën e tyre politike apo të heqin projektorin e të vënë atë privat.


Znj. M. Koja: Ata janë të lirë të veprojnë si njerëz me veshje politike, gjithmonë në raport me respektimin e detyrimeve ligjore që kanë për financimin.

Z. L. Braho: Po.

Përfaqësuesi i Bashkisë së Librazhdit: Për sa i përket këtij raportimi, unë si Sekretar i Përgjithshëm krahas shumë detyrave të tjera që kam, më ka angazhuar edhe me urdhër të posaçëm për të qenë edhe raportues. Aq sa mund ta njohim kuadrin ligjor të raportimeve, mundohemi ta bëjmë sa më mirë detyrën. Për rastin specifik, raportimi është bërë i saktë, është bërë në një ambient privat bar-kafe, jashtë orarit të punës, pa prezencën e punonjësve të bashkisë. Është bërë me kontributin personal ose pa asnjë lloj objekti shtetëror dhe ujë pa gaz, po flasim në mënyrë më të thjeshtë. Kafja është paguar me faturë private, e paraportuar në buxhetin e bashkisë. Kanë qenë ditët e para pasi është hapur ky lloj portali në KQZ. Mendoj që nuk përfshihet fare të qenit objekt ose përdorimi i aseteve publike për aktivitetin promovues të bashkisë apo të takimit me pensionistët. Për sa u përket fjalëve ose fjalive që mund

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

të merren nga konteksti, mund të thuhet që është tejkalim i asaj se çfarë duhet thënë apo çfarë është e ndaluar apo jo, këtu nuk jam i aftë ta ndaj unë. Kjo ishte në tërësi për sa i përket këtij aktiviteti.

Znj. M. Kajo: Mundem? Nga sa raportohet në faqe, është zhvilluar në orën 11:15. Ka qenë ditë pushimi, apo ditë pune? Ditë jave, apo fundjavë?

Përfaqësuesi i Bashkisë së Librazhdit: Takimi është bërë mbas dite, pavarësisht se kur është publikuar në faqen zyrtare.

Znj. M. Kajo: Raportuar, jo publikuar, raportuar në faqen e KQZ në orën 11:15.

Përfaqësuesi i Bashkisë së Librazhdit: Edhe nga oraret që kanë zyrtarët që do të marrin pjesë, domethënë lidhur me angazhimet funksionale, ndoshta edhe politike që kanë, nuk është se do të jenë fiks me oraret, se çfarë mund të raportojmë ne, me atë çfarë mund të shikohet fizikisht. Është pak e vështirë edhe kjo pjesë, duhet marrë parimisht si janë, sepse nuk mund të bashkosh shumë aktorë...


Znj. M. Kajo: Edhe në shkresën tuaj keni thënë që e keni zhvilluar në orën 10:00, që të jemi të qartë.

Z. I. Braho: Edhe sanksioni nuk është kërkuar nga Komisioneri për problemet me raportimin, është kërkuar në lidhje me atë që është thënë, prandaj është kërkuar ndaj kryetarit të bashkisë dhe jo ndaj ju si raportues. Mirë, në qoftë se s'ka ndonjë gjë tjetër..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Për Bashkinë e Librazhdit, po?

Z. I. Rusmali: Në vendim dhe në kërkesë, Komisioneri thotë: “Kryetari i Bashkisë së Librazhdit, nëpërmjet lejitimit të mbajtjes së fjalimit me përmbajtje elektorale të zotit Gjinknuri, ka përdorur postin e tij duke vënë në dispozicion të fushatës elektorale organin që ai drejton”. Deri tani kishim vënien në dispozicion të burimeve, tani shkojmë te një koncept, po të duash, edhe abstrakt, ka vënë në dispozicion organin që drejton. Ka ndonjë shpjegim për këtë term, sepse është term juridik i ri ky? Po.


Znj. M. Kajo: Organi publik është ai përkufizimi që njihet Kodi i Proceduarve Administrative, që përfshin organet e administratës publike dhe shtetërore, ai atë njihet. Ne thjesht i kemi përdorur...

Z. I. Rusmali: Faleminderit, shumë për shpjegimin e organit publik! Çështja është që ne jemi këtu dhe duhet t’i vendosim një gjobë atij, dhe gjobën do ta vendosim në bazë të ligjit. Deri tani u mësuam që u vendoska gjobë për shkak të keqpërdorimit të burimeve, aseteve publike.

Znj. M. Kajo: Veprimtarisë publike.

Z. I. Rusmali: Burimeve. Tani, përtej faktit që kemi nevojë ta kuptojmë si e paska vënë në dispozicion organin që drejton, kur ai ka marrë për krahu Damianin dhe ka shkuar në kafe, po jemi përpara një kategorie të re, se tani s’jemi më te burimet publike. Kryetari i bashkisë në vetvete del shëtitje, merr dhe gjithë bashkinë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

virtualisht dhe nuk i lejohej ta marrë bashkinë virtualisht, se bën shkelje. Këtë duhet ta kuptojmë ne, që të jemi të qetë të vendosim gjobë, apo jo?

Znj. M. Kajo: Ajo që mund t'ju them është që rastet janë në arsyetim dhe në kuptueshmërinë tonë të njëjtë më njëri-tjetrin.

Z. L. Braho: Keni pyetje tjetër? Jo. Vazhdojmë me rastin e Ministrisë të Turizmit, meqenëse procedurat kanë nisur ndaj prefektit të Qarkut të Gjirokastrës dhe më tej këtu kemi të bëjmë me mosraportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me një veprimtari publike të regjistruar me nr. 64, ID-i. Po, zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është raportuar denoncimi me nr. 64, ID-e, ku pretendohet se prefekti i Qarkut të Gjirokastrës, zoti Odise Koti, kishte organizuar edhe pjesë të dëgjësës publike të zhvilluara në ambientet e universitetit “Eqerem Cabej” për rritjen e shkallës së mbrojtjes së lumit Vjosa “Park Kombëtar”. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se prefekti i Qarkut të Gjirokastrës nuk ka qenë organizatori i këtij takimi, por organizatore ka qenë Ministria e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Duke qenë se gjatë hetimit administrativ është kërkuar edhe shpjegimi, gjatë shpjegimeve të përfaqësuesit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është pretenduar se nuk kanë pasur kredencialet dhe për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve, nuk është bërë i mundur ky raportim. Për sa më sipër, gjatë hetimit administrativ institucioni nuk ka paraqitur prova dhe fakte të arsyeshme, të cilat të provojnë se nuk ka pasur mundësi për ta raportuar. Në këto kushte, Komisioneri ka vendosur dhe ka krijuar bindjen se përfaqësuesi i Ministrisë së Turizmit ka shkelur

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023**

detyrimin ligjor duke mos raportuar veprimtarinë në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke qenë se ka pasur edhe detyrimin për të raportuar. Në këto kushte i ka kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e gjobës në masën 5 mijë lekë për personin përgjegjës për raportimet, për mosraportimin e veprimtarisë së mësipërme. Faleminderit!


Z. L. Braho: Po, faleminderit! Ka ndonjë pyetje për Gjirokastrën?

Z. I. Rusmali: E vetmja pyetje është pse e konsideroni që detyrimi ka qenë edhe i Ministrisë, edhe i Agjencisë?

Znj. M. Kajo: Në fakt, gjatë hetimit dhe dëgjësës që kemi patur me përfaqësuesit e çështjes, me perfektin e Qarkut të Gjirokastrës, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në plan të parë u krijua përshtypja që ishte AKZM-ja, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, organizatore e këtij takimi. Nga administrimi i provave, ftesa dhe organizimi ishte bërë nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit. Për këto arsye ne mendojmë që përgjegjësinë për ta raportuar e ka pikërisht Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit dhe jo Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Pavarësisht faktit që është organ varësie i ministrisë, ajo ka *account-in* e vet, raporton më vete për veprimtaritë e saj, por në rastin konkret për këto aktivitete të zhvilluara në Universitetin “Eqerem Cabej” në Gjirokastër, ftesa, organizmi, pra e-mailet, që u administruan ishin nga Ministria e Turizmit dhe ftesa ishte në emër të ministrit.

Z. I. Braho: Faleminderit! Kalojmë me rastin e Bashkisë së Poliçanit. Edhe një herë, te rasti i Ministrisë, sepse thjesht thuhet personi përgjegjës, po duke qenë se

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

vendosëm një sanksion administrativ, sanksionet administrative duhet të jenë të identifikueshme ndaj....

Znj. M. Kajo: Është sekretari i Përgjithshëm.

Z. I. Braho: Duhet të qartësohet kjo pjesë.


Znj. M. Kajo: Është e vendosur në vendim, është emër, mbiemër.

Z. I. Braho: Është me emër, me mbiemër, në rregull. Bashkia e Poliçanit nuk ka raportuar, pra kemi të bëjmë sërish me një aktivitet të paraportuar. Janë 2 veprimtari publike të regjistruara me numrat 54 dhe 55. Po, zoti Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Bashkia e Poliçanit ka pas detyrimin t'i raportojë të dyja këto veprimtari pasi kanë qenë publike. Ajo e para mes miqsh e dashamirës për një veprimtari të zhvilluar në ceremoninë e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë së Poliçanit dhe denoncimi tjetër me përfaqësuesin e sindikatës së punonjësve dhe ish-punonjës të Kombinatit Mekanik në Poliçan, një takim për të dëgjuar shqetësimet e tyre për të vlerësuar mundësinë e gjetjes së zgjedhjes së plotë. Këto janë veprimtari publike dhe personi përgjegjës ka qenë i detyruar, sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12 të bëjë raportimin. Nuk e ka bërë brenda afatit të përcaktuar në ligj, kështu që Komisioneri ka vendosur propozimin për gjobë për personin përgjegjës për raportim të Bashkisë së Poliçanit. Faleminderit!

Z. I. Braho: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje për këto?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Për sindikatën kam unë pyetje. Ju e keni verifikuar ku është zhvilluar aktiviteti?

Znj. I. Osmanaj: Ka qenë në një ambient të hapur. Bashkia e Poliçanit, në fakt, ka 2 veprimtari publike të paraportuara. Ceremonia e dhënies së “Titullit të Nderit” zotit Shkëlqim Beqiri, është bërë në ambientet e bashkisë ...

Z. I. Rusmali: Jo, jo nuk më duhet ajo, më duhet ajo e sindikatës.

Znj. I. Osmanaj: Me përfaqësuesit e sindikatës të punonjësve dhe ish-punonjësve të Kombinatit Mekanik në Poliçan është bërë në një ambient të hapur, por janë vënë ...

Z. I. Rusmali: Linku që ju na kini vënë këtu, linku për sindikatën na çon te Ministri i Brendshëm.


Znj. I. Osmanaj: Mund ta verifikojmë, sepse mund të jetë thjesht një gabim material në momentin që është administruar ky si link, që është bërë *copy paste*.

Z. I. Rusmali: Dakord, se ndryshe nuk e kuptojmë dot.

Z. I. Braho: Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera.

Z. K. Bele: Siç e kuptoj te dekorimi i këtij këngëtari ose se çfarë është ky zotëria, ç’rëndësi ka, kjo është e ngjashme me mbledhjen e këshillit bashkiak. Pra bashkia jep edhe tituj, më duket se është ushtrim funksioni i bashkisë, që midis të tjerash, jep

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

tituj nderi. Çfarë detyrimi ka të raportojë këto lloj aktivitetesh, se dakord ai nuk e ka raportuar..


(Diskutim pa mikrofon)

Z. K. Bele: Po, publik është i gjithë aktiviteti i bashkisë, se i bie ne po ndalojmë të funksionojnë organet e administratës, nuk është ky qëllimi, për katër muaj të mbyllet bashkia, të ndahen vetëm pagat! Pra, në qoftë se këtu nuk ka një veshje me një aktivitet politik, pra s'ka qenë deputeti apo ku e di unë diçka tjetër, raportim i një aktiviteti rutinë, dhënia e titullit të nderit, është njësoj....

Znj I. Osmanaj: Po kanë qenë shumë të ftuar, pjesëmarrësit kanë qenë të shumtë dhe ka pasur dhe mediatizim. Dhënia e titullit të nderit nënkupton që të bëhet vetëm brenda ambienteve të bashkisë pa pasur nevojë për pjesëmarrje të mediatizuar të lartë. Atje ka pasur pjesëmarrje mediesh.

Z. K. Bele: Aktivitet ku shkojnë njerëz mund të jetë edhe ditëlindje apo dalja në pension e punonjësit më të vjetër të bashkisë. Më kujtohet një eksperiencë, dikur e kemi bërë, doli dikush në pension i dhamë dhe një dekoratë në një institucion, ku kam punuar unë dikur. U mbledhën të gjithë dhe dikush ndoshta edhe i filmoi, por ky nuk është aktivitet politik dhe nuk ka detyrim për ta raportuar aktivitetet. Ne nuk mund të gjobisim bashkinë, sepse nuk ka raportuar një aktivitet i cili nuk ka *background* politik, pastaj 10 apo 20 vetë kjo është irrevelante nuk është e rëndësishme. Si e tillë ky aktivitet unë nuk e shoh pse duhet raportuar. Pastaj ndoshta këto duhen hetuar më thellë, kjo e sindikatës apo punonjësit, po ne s'mund të ndalojmë bashkinë në 4 muaj që të kryejë aktivitete, në të cilat në ndonjë rast të caktuar, për shkak të natyrës, vijnë edhe persona të tjerë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. I. Osmanaj: Filluam procedurën e hetimit, në fakt, por nuk morëm asnjë përgjigje nga ana e Bashkisë së Poliçanit, nuk kemi marrë asnjë korrespondencë qoftë shkresore, qoftë nëpërmjet *emali*-it. Gjithashtu, e kemi njoftuar 2 herë edhe nëpërmjet telefonit dhe *email*-it, që të marrin pjesë në seancë publike të zhvilluar nga Komisioneri, por nuk kemi pasur asnjë përgjigje sërish, as pjesëmarrje.

Z. K. Bele: Pra, e thënë ndryshe po propozohet që ne ta gjobisim, sepse ata nuk kanë bashkëpunuar? Ka raportuar raste të tjera?

Znj. I. Osmanaj: Do ta verifikojmë dhe do të kthejmë përgjigje.

Z. K. Bele: Unë shoh raportimin e hetimeve të thelluara te rasti i Bashkisë së Fierit, ndërsa te këto raste duken sikur është marrë...

Znj. M. Kajo: Janë vetëm për mosraportim, janë për çështje vetëm për faktin e mosraportimit.

Z. K. Bele: Jam dakord, po e kini parasysh që ne trajtuam disa raste të mëparshme dhe në disa prej rasteve vetë Komisioneri kishte konstatuar që nuk ishin veprimtari publike, pavarësisht denoncimeve. Edhe KAS-i në një vendimmarrje të mëparshme e ceku këtë problem, që disa veprimtari nuk janë veprimtari publike, si të tilla nuk kanë detyrim për raportim dhe s'mund të ketë ndëshkim për mosraportim të një veprimtarie, që dukshëm nuk është e tillë, nuk duhet të jetë objekt i raportimit. Këtu duhet bërë pak kujdes.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Znj. M. Kajo: I drejtë konstatimi juaj, në fakt, edhe ne kemi pasur këtë dilemë gjatë vlerësimit të veprimtarive, që e bëjmë në mënyrë të përjavshme, tani e kemi mbi baza ditore. Kemi pasur edhe raste të tjera të raportuara, ka qenë Bashkia e Përmetit, Bashkia e Vlorës, kanë qenë dekorime këngëtarësh apo grupe muzikore apo poetë, shkrimtarë të zonave, që i kanë raportuar në KQZ. Në fakt, këtë qenë veprimtari me publik të gjerë, përgjithësisht këto janë me publik, se janë të ftuar artdashësit, janë të ftuar familjarët, janë të ftuar rrethi miqësor e shoqëror. Vetëm ky risk e bën atë, pra pjesëmarrja e gjerë e njerëzve e ekspozon ndaj ndonjë rreziku bërje fushate, po në vetvete, sigurisht, ajo është veprimtari si të gjithë të tjerat që të raportohen, e një kryetari bashkie, është veprimtari normale e tija. Në këtë kuptueshmëri e kemi pasur edhe ne merak, po kjo është.

Z. L. Braho: Faleminderit! Vazhdojmë me rastin e gjashtë, që është Bashkia e Skraparit, sërish për mosraportim të një aktiviteti, që është një aktivitet i datës 7 shkurt 2023. Pra dhe këtu jemi për mosraportim. Është një aktivitet takimi informues për projektin e fituar në kuadër të ndërtimit të një qendre sportive në shkollën 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”. Në takim morën pjesë mësues dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare, përfaqësues nga komuniteti, si dhe përfaqësues të projekti BE-së për bashkinë. Pra, ju e keni konsideruar aktivitet publik të paraportuar. Pyetje?

Z. I. Rusmali: Unë desha të dijë kush ka marrë pjesë në aktivitet nga ofiqarët?

Znj. I. Osmanaj: Atëherë në aktivitetin publik ka pasur prani nxënësish të shkollës 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”. Gjithashtu edhe mësues dhe ishte e pasqyruar edhe në rrjetet sociale.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord. Unë i shoh fotot nga faqja zyrtare e bashkisë, po unë nuk i njoh këto. Nga bashkia kush merr pjesë në aktivitet?

Znj. I. Osmanaj: Pjesëmarrja e publikut...

Z. I. Rusmali: Si?

Znj. I. Osmanaj: Pjesëmarrja e publikut në këtë aktivitet.

Znj. M. Kajo: Ne nuk i identifikojmë se kush janë, po ne shohim që janë publik.

Z. I. Rusmali: Jo, nuk më duhet, publikun e shoh dhe unë nuk po kundërshtoj për publikun,

Znj. M. Kajo: Jo, nuk e identifikojmë dot.

Z. I. Rusmali: Ka kryetar bashkie aty prezent, apo s'ka?

Znj. M. Kajo: Nuk e identifikojmë dot.

Z. I. Rusmali: Se ju keni listë zyrtarësh për të cilët ekziston detyrimi për raportim, apo jo? Në qoftë se është specialisti i urbanistikës, që po shpjegon projektin, specialisti i urbanistikës nuk çon te detyrimi për raportim. Në qoftë se është kryetari i bashkisë, çon te detyrimi për raportim. Kështu siç e kam kuptuar unë atë vendimin nr. 9, mbase e kam kuptuar gabim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.29.03.2023

Znj. M. Kajo: Po, janë titullarët e institucioneve, titullarët e bashkisë...

Z. I. Rusmali: Në rastin e kësaj bashkie, ky burri serioz me syze, poshtë Ismail Qemalit kush është?

Znj. M. Kajo: Nuk e kemi identifikuar.

Z. I. Rusmali: Pa identifikuar.

Z. L. Braho: Vazhdojmë me rastin e Bashkisë së Roskovecit, që vijnë për herë të dytë në KAS, duke raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, një veprimtari publike të regjistruar me nr. 88. Denoncimi ka të bëjë me një aktivitet “Mirëmëngjes” dhe me projektin “Për ngritjen e kapacitetit të grave dhe vajzave artizane”, që ka për qëllim organizimin e grave dhe vajzave për t’u futur në tregun e punës, që shumë shpejt do të marrë jetë. “Ju urojmë një ditë të mbarë!” Ky duhet të jetë postimi në facebook besoj. Bashkia është njoftuar për të marrë pjesë, nuk ka patur përfaqësues. Jemi në të njëjtat kushte: çfarë pjesëmarrësish ka patur?

Z. Y. Merkaj: Ka qenë kryetarja e Bashkisë Majlinda Bufi, drejtori i kulturës dhe 25 zonja, banuese në Bashkinë e Roskovecit. Në datën 9 shkurt 2023 është zhvilluar aktiviteti dhe është veprimtari publike, por nuk është raportuar. Ka pasur detyrimin për ta raportuar, ka shkelur nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe Komisioneri i ka propozuar KAS-it për marrjen e masave administrative, gjobë në masën 5 mijë lekë për personin përgjegjës për raportimet në Bashkinë e Roskovecit. Faleminderit!

Z. L. Braho: Ka ndonjë pyetje?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. I. Rusmali: Do të bëj një diskutim të ngjashëm me diskutimin e Kolit. Ne këtu ecim në terren të pashkelur kam përshtypjen unë, i cili ka nevojë për rregullim jo për ndëshkim. Siç e shoh unë materialin, ky është material fotografik. Takimi duket sikur zhvillohet në zyrat e bashkisë, në sallën e mbledhjeve të bashkisë. Në zyrat e bashkisë kanë ardhur gratë zejtare dhe po diskutojnë sesi të promovojnë zejen e Roskovecit në gjithë Shqipërinë. Nuk ju duket sikur kjo është pjesë e detyrave funksionale të institucionit dhe nuk ka asnjë lidhje me çështjet që janë objekt i trajtimit nga ne? Përndryshe, e gjithë agjenda e kryetarit të bashkisë, duhet të ishte e raportueshme. Kryetari i bashkisë, gjatë ditës së tij të punës, takon dhjetëra, i takon në zyrën e tij, i fton të diskutojnë për probleme lokale e të tjera me radhë. Në termin më të gjerë të mundshëm, publik janë ata, se njerëz janë të shkretët. Mos vallë duhet të arrinim ne në konkluzionin që aktivitetet e kësaj natyre, takimet e punës funksionale institucionale, që bëhen në mjediset e institucionit, nuk mund të konsiderohen si fushë veprimi e rregullave tona? Ndoshta do të ishte kjo zgjidhja më racionale. Nuk e ndajmë dot ne këtë punë, po ju e ndani më shumë se ne, se ju keni mundësi ta ndani me rregullatorin.

Z. K. Bele: Në bashki mund të shkojë një klasë dhe shkon takon kryetarin dhe sheh si funksionon pushteti. Mund të jetë një grup, ku di gjë unë, nga Fakulteti i Drejtësisë që janë në masterin administrativ ose në lëndën e drejtës administrative dhe bëjnë një vizitë në institucion, takojnë kryetarin apo ministrin. A duhen raportuar këto dhe a ka kuptim të monitorohen këto, sepse krijojnë një volum të panevojshëm?

Znj. M. Kajo: A mund të them diçka? Gjithçka që ju diskutuat është shumë e drejtë dhe shumë herë ne vihemi para pozitës së pikëpyetjeve: a raportohet çdo takim, një

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

kafe që pi kryetari i bashkisë apo një takim që bën me disa të rinj, që i trokasim në derë? Ai bën një selfi në zyrë, e publikon në faqen e vet, e publikon në faqen e bashkisë etj., etj. Janë gjëra që t'i ndajë akti ligjor apo nënligjor, patjetër nuk janë çështje që mund t'i ndajmë në në kuptueshmëri të përgjithshme. E vetmja gjë që në kuptojmë dhe mundohemi ta argumentojmë më së miri, me aq sa mundemi, është që ky kujdes i shtuar duhet vetëm për këta 4 muaj para zgjedhjeve. Sigurisht që në një plan diskutimi a e vështirëson punën e kryetarëve të bashkive, se po flasim për zgjedhjet vendore, po e vështirëson në, fakt. Por vetë legjislatori ka kërkuar një kujdes të shtuar, por nuk ka bërë një ndarje të mirë se çfarë është e raportueshme edhe se çfarë është e paraportueshme. Në një plan të parë duket sikur gjithçka që ata bëjnë duhet ta raportojnë. Pra, dhe ajo që përmenda është rast që ne e kemi administruar, të paktën, sa merr informacion nga faqja e një bashkie, ishte kryetari i bashkisë të cilit i kishin trokitur disa të rinj të një shoqate, i kishte pritur në zyrën e tij dhe në përfundim të diskutimit kishin bërë një foto kujtim, dhe kjo është e publikuar. A është kjo veprimtari publike që raportohet e kryetarit të bashkisë? Ne menduam që jo. Kështu na u krijua në atë moment bindja. Për rastin konkret menduam që po.

Z. I. Rusmali: Pavarësisht se unë besoj se kjo është më pak sesa takimi me të rinjtë. Mund të kthehem se është e njëjta gjë, diskutimi për Poliçanin. I ke fotot e Poliçanit? Janë aty, po po Poliçani është. I kthehem çështjes së Poliçanit, që ju verifikuat. Nga postimi unë kuptoj, mbase unë e kuptoj gabim gjënë. Takimi me sindikatën e minatorëve, i bërë nga kryetari i bashkisë me prezencën e ministrit të Brendshëm, se është ministri i Brendshëm besoj, informacioni që ne kemi është vetëm kaq: takim pune me përfaqësues të sindikatës minatorë dhe ish-minatorë për të diskutuar për problematikat e tyre, se paskan problematika. Mos vallë jemi edhe këtu në natyrën

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

e një veprimtarie rutinë funksionale? Po qajnë hallet me njëri-tjetrin për një çështje konkrete dhe zotëria që është në mes ka funksione që lidhen me këtë gjë, ndoshta nuk është si deputet, ndoshta është si ministër aty.

Znj. M. Koja: Po, po si ministër mund të jetë. Këtu kthehemi në një çështje diskutimi tjetër, që edhe ajo është një gjë që ne po e diskutojmë dhe do të na duhet shumë shpejt të marrim një vendim edhe për këtë. Veprimtaria bëhet publike kur ka qëllim të informojë publikun rreth përmbajtjes së saj dhe këto veprimtari janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Në këtë moment ne kemi parë lidhjen që ligji na dikton, që është një veprimtari që ka qëllim të informojë publikun. Në fakt, unë nuk di sa i interesuar është publiku, se ç'bën sindikata e minatorëve. Pra, kjo është një çështje tjetër, por nuk i kemi hyrë fare këtij arsytimi dhe jemi ndalur vetëm te fakti që përderisa bashkia e bën publik takim, do të informojë publikun rreth përmbajtjes së këtij takimi. Pra, ka qëllim të informojë, vetëm këtu jemi ndalur.

Z. I. Rusmali: Përzierjen e zakonshme që ndodh rëndomë prej 2 vjetësh, përzierjen e veprimtarisë me *facebook*-un, me postimin; postimi është një gjë tjetër, veprimtaria është një gjë tjetër. Veprimtaria që ne po shqyrtojmë është takimi i zhvilluar në një zyrë midis 10 burrave, 12 burrave, kjo është veprimtaria. Fotot janë një gjë tjetër, janë një gjë që kanë ardhur më vonë, por ajo që ne shqyrtojmë është: këta 10 burra po bëjnë një veprimtari që duhet të raportohet? Pra, kur u mbledhën bashkë, bënë diçka që duhet të raportohet, jo postimi, se postimi është një histori tjetër dhe që të arrish... Domethënë, formalisht ju mund të jeni në rregull dhe thoni janë publikë. Përfaqësuesit e sindikatës nuk janë punonjësit e bashkisë, sa kohë që nuk janë punonjësit e bashkisë janë të tretë dhe formojnë publik, por pyetja që shtroj unë është: mos jemi përpara ushtrimit të funksioneve normale të një institucioni?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Ndoshta duhet përjashtuar nga kategoria, sepse nuk është çështja e lodh apo se lodh kryetarin e bashkisë, domethënë i ngarkon peshë apo jo? Kryetari i bashkisë teksa ka kohë të bëjë postime në *facebook*, ka me siguri kohë që të bëjë dhe raportime, nuk është ky problemi. Problemi është a i intereson procesit elektorale kjo natyrë aktivitetesh? Duhet kjo natyrë aktivitetesh të meritojë vëmendjen e KRIIK-ut apo të tjerëve apo këto duhen lënë mënjanë, që vëmendja të përqendrohet saktësisht te çështjet që shqetësojnë opinionin publik dhe që përbëjnë realisht mundësi potenciale për keqpërdorim të burimeve shtetërore? Këtë pyetje ndoshta duhet ta gatvani më shumë ju.

Z. K. Bele: Të njëjtën koment kam, sepse kur lexojmë nenet e kodit, këto duhet t'i shikojmë në kuadër të gjithë frymës së kuadrit. Pra, jemi te kapitulli i financimit të zgjedhjeve dhe i fushatës. Pra, qëllimi dhe lënda jonë si KQZ, si Komisioner dhe si KAS, fokusi ynë është fushata. Ne nuk jemi organi që bën transparencën e bashkisë për çfarëdolloj aktiviteti që ka bashkia. E thatë, e parafrizuar ju shumë saktë më parë. Pra, lënda jonë është e mirëfilltë zgjedhore, patjetër që ka fusha prerjeje, por do të duhet të jetë evidente jo ne të dyshojmë se mos këta, kur janë takuar, kanë folur edhe për ndonjë gjë politike. Në fund të ditës dhe paqartësia e ligjit nuk mund të nxisë, mendoj unë, penalizimin e subjekteve. Paqartësia e ligjit, ndoshta ata që kanë në dorë ta ndryshojnë ligjin ose aktet nënligjore, nëse mund të ceken aktet nënligjore, siç është edhe vendimi i famshëm 9, që mund të ketë nevojë për t'u riparë, për të reflektuar, e theksoj, për të reflektuar, përvojën e krijuar në dy palë zgjedhje, përfshi edhe ato të pjesshmet. Sot jemi para faktit që ishte ligji i ri, një akt i ri rregullator i nxjerrë në një periudhë të shkurtër kohore, që patjetër ka vlerat e veta, por ndoshta këto gjëra duhen parë, se nuk na bën sens që ne të mblidhemi dhe ju të merrni

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

vendime për një takim të paindetifikuar që nuk është raportuar. Nuk mendoj se është ky qëllimi.

Z. L. Braho: Faleminderit! Vazhdojmë me rastin e Bashkisë së Lezhës, që nuk ka raportuar në faqen e KQZ-së 6 veprimtari publike. Janë një sërë denoncimesh, që kanë të bëjnë me përkujtimin e 550-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Takimi me banorët e lagjes SMT, ku prej 30 vjetësh mashtrohen duke i lënë me rrugë të shkatërruara. Bashkia e Lezhës do të bëjë sistemin e rrugëve. Denoncimi tjetër që ka të bëjë me një inspektim në rrugën lidhëse ndërmjet rrugës “Dedë Shabani” dhe asaj “Azem Hajdari”. Denoncim tjetër, vazhdojmë në terren aty ku kemi punët dhe ku marrim burimet dhe mbështetjen për ndryshimin e përditshëm. Inspektim punimesh edhe kjo. Tjetra është një projekt “Dua të luaj”, që po zbatohet në qytetin e Lezhës, i cili do t’i sjellë qytetit zona me tri fusha: tenis, basketboll, volejball. Dhe denoncimi 126 në Kallmet të lagja “Gjatore” në bashkëbisedim me kryefamiljarë për problematika të ndryshme. Këto janë 6 aktivitete që janë të paraportuara, sipas KQZ-së, për të cilat kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës në Bashkinë e Lezhës. Zoti Merkaj, pa përsëritur aktivitetet thjesht, një...

Z. Y. Merkaj: Edhe Komisioneri në arsyetimin e tij i ka vlerësuar dhe i ka konsideruar të gjitha këto veprimtari publike, të cilat duhet të ishin raportuar sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Këto nuk janë raportuar nga personi përgjegjës. Në këto kushte Komisioneri ka kërkuar marrjen e masave administrative ndaj këtij personi në masën 5 mijë lekë për mosraportim, në shkelje të plotë të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*


Z. I. Rusmali: Unë kam një problem këtu me veprimtarinë “Dua të luaj”. Ajo që shoh unë në *Facebook* nuk më rezulton veprimtari publike. Aty në një shesh shumë të madh ndërtimi të gjitha fotot tregojnë kryetarin e bashkisë me drejtuesin e punimeve, duke e parë projektin në letër dhe duke parë sesi po bëhej në terren, dhe diku tregojnë dy punëtorë të kompanisë që bën punimet duke kthyer hekurat. Unë nuk shoh publik në asnjë nga fotot e postuara dhe sa kohë që nuk ka publik për mua nuk është veprimtari publike. Të tjerat, me aq sa pash unë, ishin besueshëm që të gjitha veprimtari publike. Në qoftë se nuk janë raportuar, është shkelur detyrimi për raportim, por te kjo nuk më del.

Z. L. Braho: Dakord. Vazhdojmë me Bashkinë e Bulqizës, që është pika 9 në kërkesë, që nuk ka raportuar një veprimtari publike, numër 124, që ka të bëjë me 75-vjetorin e krijimit zyrtarisht të minierës më të madhe të kromit në vend. Sipas Komisionerit është veprimtari publike e paraportuar, ndaj edhe ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës. Ka ndonjë pyetje?

(Diskutime pa mikrofon)

Znj. I. Osmanaj: Në momentin që ka ardhur indicia për denoncim, ai ka qenë në funksion, madje është thirrur në seancë publike, ku ka marrë pjesë dhe ka paraqitur edhe pretendimet e tij. Domethënë para kësaj veprimtarie ai ka raportuar, është verifikuar që ka raportuar dhe në këto kushte për këtë veprimtari duhet të kishte raportuar. Ka qenë për dy veprimtari të tjera. Për këtë veprimtari nuk dha shpjegime, ndërsa për dy veprimtaritë e tjera, të cilat i arsyetoi me pretendimet e tij, që nuk ishte pajisur me kredenciale në atë periudhë, kemi vijuar me pushimin e procedimit administrativ, ndërsa për këtë nuk është se dha shpjegime. Në shkresën 10071, datë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

28.2.2023 administruar me tonën 12049, datë 2.3.2023, bëhet me dije se në aktivitetin e 75-vjetorit të krijimit të minierës së kromit në Bulqizë organizuesi është Bashkia e Bulqizës. Aktiviteti u zhvillua në kinema, ditën e shtunë, në datë 18 në orën 10:00. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin të ftuar ata të cilët kanë punuar dhe atë që punojnë në minierë, nga punëtorë të thjeshtë deri drejtues. Prani të medieve të ftuara nga ana jonë nuk kemi pasur në aktivitet, po është postuar në rrjetet e tyre sociale të bashkisë.


Z. L. Braho: Vazhdojmë edhe me rastin e fundit, që i përket Bashkisë së Elbasanit, që janë tri veprimtari publike që janë të paraportuara. Njëra që ka të bëjë me praninë e kryetarit të bashkisë në ambientet e një kompanie të pajisur me teknologji moderne. Qeveria dhe Bashkia e Elbasanit do të vijojnë politikat mbështetëse. Denoncimi 52 është në një fabrikë tjetër që merret me konstruksione metalike, lider në fushën e përpunimit të metaleve dhe tjetra është në ambjentet e një mobilierie. Këto janë aktivitete publike, Ylli?

Z. Y. Merkaj: Komisioneri ka vlerësuar që këto janë aktivitete publike, pasi kanë qenë në praninë e drejtuesit politik të qarkut dhe si rregull duhet të ishte raportuar, pasi nuk është provuar se cilat kanë qenë thirrjet apo mesazhet që kanë dhënë drejtuesi politik i qarkut dhe kryetari i bashkisë. Është konsideruar si veprimtari që duhej të raportohet. Faleminderit!

Z. L. Braho: Këto linqet këtu janë linqe që i ka publikuar drejtuesi politik? Ky i pari, për shembull, që është bashkë me Gledin? Është i drejtuesit politik.

Znj. I. Osmanaj: Këto janë linqe që na i ka vënë në dispozicion denoncuesi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.03.2023*

Z. L. Braho: Këto janë kërkesat. A ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët në përgjithësi? Në qoftë se nuk ka, përfaqësuesi i Bashkisë së Librazhdit, sekretari i Përgjithshëm, është larguar. Kështu që, Ylli besoj se ju i qëndroni kërkesës. Keni ndonjë rast që keni ndryshuar mendim, apo për të gjitha jeni njësoj?

Z. Y. Merkaj: ...Sipas propozimit të Komisionerit.

Z. L. Braho: Mirë, KAS-i do të tërhiqet për vendim dhe për momentin e shpalljes së vendimit, datën dhe orën do t'ju njoftojmë paraprakisht për administratën dhe për palët.

Seanca deklarohet e mbyllur.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

